

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6008  
E hënë, 24 shkurt 2020  
çmimi 0.40 €

Presidenti Thaçi niset  
për në ShBA, do të ketë  
takime me administratën  
amerikane | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR ABBRUCH GMBH**  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", NAIM FETAHU | FAQE 4-5



## DO T'I FITOJ ZGJEDHJET NË PODUJEVË

Kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për kryetar të Komunës së Podujevës, Naim Fetahu, beson se do të fitojë më 15 mars. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se qytetarët e kësaj komune në këto zgjedhje do të votojnë për ndryshim. Fetahu ka deklaruar se Komuna e Podujevës ka nevojë për fitoren e PDK-së. Sipas tij, Podujevës i duhet një qeverisje që në qendër të vet ka interesin e qytetarëve, një qeveri që krijon perspektivë për të rinjtë, siguron drejtësi për punëtorët dhe mbështet bujqit. "20 vjet pas luftës dhe nën udhëheqjen e vetëm një partie, Podujeva sot numëron më së shumti të rinj të papunë, më së paku zhvillim ekonomik, infrastrukturë të rrënuar, qeverisje lokale të kapur dhe të korruptuar, monopol të shërbimeve publike, punësime ekskluzivisht vetëm partiake dhe familjare", ka thënë ai. Fetahu ka pohuar se të dy kundërkandidatët e tij janë të konsumuar dhe pa ide

### OPINION

QEVERIA E RE E KOSOVËS  
DUHET TA SQAROJË  
POLITIKËN E VET NDAJ  
SERBISË | F. 11

Nga Jakup  
KRASNIQI



VETËM RECIPROCITETI MUND  
TA ZËVENDËSOJË TARI FËN | F. 11

Ismajl  
KURTESHI



### AKTUALE

KJO JAVË NË KOSOVË DO TË  
JETË ME DIELL | F. 6

GAP-i: NGA 903 PREMTIME,  
KOMUNAT KANË PËRMBUSHUR  
VETËM 304 | F. 10

### EKONOMI

KORONAVIRUSI NDIKON NË  
RËNIEN E BLERJEVE ONLINE  
NGA KINA | F. 8

ABDIXHIKU KËRKON ANULIMIN E  
PROJEKTIT TË NDËRTIMIT NË  
LIQENIN E BADOVCIT | F. 8



### SPORT

BALLKANI I PAGABUESHËM,  
GJILANI RUAN SHPRESAT PËR  
TITULL | F. 20


## Kosova dhe Shqipëria ndërmarrin masa për t'u mbrojtur nga koronavirusi | FAQE 3

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se ekipet e këtij instituti janë duke përcjell me vëmendje situatën epidemiologjike me koronavirus në botë. Sipas IKShPK-së, në vendin tonë nuk ka koronavirus. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike ka bërë pub-

like edhe masat e parandalimit të këtij virusi. Derisa në Itali raportohet për dy të vdekur dhe mbi 130 të infektuar nga ky virus, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka bërë thirrje që populli shqiptar të mos bie pre e lajmeve të rreme. Ai



ka thënë se koronavirusi nuk e ka prekur Shqipërinë dhe ka bërë me dije se janë marrë të gjitha masat në rast shfaqjeje të koronavirusit



## Rikthehen sulmet me vezë ndaj zyrtarëve të shtetit | FAQE 7

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegji.biznesi.com  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Serbia blen armë nga Rusia me gjithë kërcënimet për sanksione amerikane

**BEOGRAD, 23 SHKURT** - Serbia ka blerë një sistem të sofistikuar kundërajror nga Rusia, pavarësisht sanksioneve të mundshme amerikane kundër shtetit ballkanik, që zyrtarisht synon anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, tha të dielën se sistemet kundërajrore Pantsir S1, janë blerë pas këshillave nga presidenti rus Vladimir Putin. "Blijeni Pantsirin. Është treguar shumë i efektshëm në Siri",

citoi ai presidentin rus t'i ketë thënë në njërin nga takimet e tyre të shpeshta kohët e fundit. "Ky sistem kundërajror është shumë efektiv kundër dronëve që janë bërë shumë thelbësorë në luftën moderne", tha presidenti serb, ka njoftuar voa.

Me gjithë synimet për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian, Serbia nën udhëheqjen populiste të presidentit Vuçiq, ka forcuar lidhjet politike e ushtarake me aleatën e saj sllave, Rusinë.

Serbia është zotuar të qën-

drojë jashtë NATO-s dhe ka refuzuar t'u bashkohet sanksioneve perëndimore kundër Rusisë për shkak të politikës së saj ndaj Ukrainës.

Armatosja e Serbisë nga Rusia shihet me shqetësim në Perëndim, në një periudhë tensionesh në rritje në Ballkanin që u përfshi në luftëra shkatërruese në vitet e 90-ta. NATO ndërhyri kundër Serbisë në vitin 1999 për t'u dhënë fund mizorive ndaj shqiptarëve të Kosovës.

Zyrtarët amerikanë kanë folur hapur për vendosjen e sank-



sioneve kundër Serbisë në rast se Moska i shet më shumë armë, veçanërisht të

tilla që mund të rrezikojnë sigurinë e vendeve fqinje anëtare të NATO-s.

## Partitë paralajmërojnë fushatë të tensionuar elektorale në Maqedoni

Edhe pse ende nuk ka nisur zyrtarisht, partitë politike paralajmërojnë se fushata elektorale për zgjedhjet e parakohshme më 12 prill do të jetë një nga fushatat më të tensionuara që mund të jenë zhvilluar ndonjëherë në Maqedoninë e Veriut

**SHKUP, 23 SHKURT** - Partitë politike paralajmërojnë se fushata elektorale për zgjedhjet e parakohshme më 12 prill, e cila ende nuk ka nisur zyrtarisht, do të jetë një nga fushatat më të tensionuara që mund të jenë zhvilluar ndonjëherë në Maqedoninë e Veriut.

Ndryshimi i emrit të shtetit, proceset gjyqësore kundër ish-zyrtarëve, rasti "reket" i qeverisjes së tanishme e afëra tjera pritet të dominojnë fushatën duke ndarë partitë në dy blloqe, në "tradhtar të kauzës kombëtare" dhe "patriot të së ardhmes evropiane të vendit". Se fushata do të jetë e pistë dhe komprometuese e ka thënë edhe kryeministri, Oliver Spasovski. "Jam i sigurt se kjo fushatë zgjedhore do të jetë një nga më të pistat në historinë e vendit. Jam i sigurt se lajmet e rreme dhe propaganda mediatike do të jenë përditshmëri e procesit zgjedhor. Por, institucionet shtetërore janë të gatshme për të siguruar që zgjedhjet të mbahen në rrethana nor-

male", ka deklaruar Spasovski në një intervistë për revistën EU Observer, ka njoftuar rfe.

Nga LSDM-ja thonë se qëllimi i opozitës është që përmes lajmeve të rreme dhe medieve të financuara me para të dyshimta, të kthejnë vendin në periudhën e qeverisjes së Nikolla Gruevskit. "VMRO-DPMNE-ja po zhvillon fushatë të zezë mediatike kundër shtetit me qëllim që të kthejë në pushtet Nikolla Gruevskin dhe të gjithë kriminelët e partisë. Me para të pista, Mickoski dhe VMRO-DPMNE po financojnë mediet që janë kundër të arriturave në shtet dhe kundër interesave të qytetarëve", ka deklaruar Bogdanka Kuzeska, nga LSDM-ja

Por, me akuza të ngjashme edhe nga VMRO DPMNE-ja madje duke e krahasuar pushtetin me nazizmin. E gjithë kjo, sipas opozitës tregon se LSDM-ja është në panik nga siç thonë, disfata që e pret në zgjedhjet e ardhshme. "Gjuha e urrejtjes që po përhap LSDM-ja në stilin e nazistëve nga



shekulli i kaluar duhet menjëherë të ndërpritet. Nazizmi është mundur nga aleatët, por duket qartë se rrënjët ende i kanë mbetur në struktura të caktuara në LSDM. Kësaj politike duhet t'i jepet fund dhe kjo do të ndodhë në zgjedhjet e 12 prillit", ka deklaruar Zhaklina Peshevaska, deputete e VMRO DPMNE-së.

Përplasje para fushatës ka edhe mes partive shqiptare, por ende jo në nivelin e partive maqedonase.

Nga Bashkimi Demokratik për Integritim thonë se do të angazhohen për atmosferë

demokratike dhe paqësore si dhe për zgjedhje të lira, që qytetarët të munden pa presion të realizojnë të drejtën e votës. "Ne presim që të kemi një fushatë fer, të lirë dhe demokratike e të qetë. Ne maksimalisht jemi të përqendruar në fitoren e radhës absolute të BDI-së", ka deklaruar, Arbër Ademi, anëtar i kryesisë së kësaj partie.

Fitore pret edhe opozita shqiptare e cila me gjasë do të garojë në dy blloqe, dhe të dyja si synim kanë fitoren ndaj BDI-së. Nga koalicioni mes Aleancës për Shqiptarët dhe

partisë Alternativa thonë se fushata e tyre do të jetë dinjitoze, pa etiketime e fyerje pasi në fokus do të ketë siç thonë "demaskimin e të gjitha dështimeve të BDI-së, jo vetëm gjatë këtij mandati qeverisës, por që kur ajo është pjesë e pushtetit në 15 vitet e fundit". Për zgjedhje të lira dhe demokratike me fushatë korrekte sipas standardeve ndërkombëtare kanë apeluar të gjithë diplomatët perëndimorë në vend duke theksuar rëndësinë që ka kjo për procesin e integritimit evropian të Maqedonisë së Veriut.

## Zaevi kapet duket kontrolluar drejtësinë

**Shkup, 23 shkurt** - Deputeti i VMRO-DPMNE-së, Antonio Milloshovski, në një konferencë për shtyp, ka publikuar të dielën një audio-incizim, në të cilën pretendon se ish-kryeministri Zoran Zaev bisedon për vendime të Gjykatës

Supreme në Maqedoninë e Veriut.

Sipas Milloshoskit, Zaevi në mënyrë direkte është përzier në vendimet e gjyqësorit. Ai, gjithashtu, ka thënë se ish-prokurorja Katica Janeva ka qenë e lidhur ngushtë me liderin e LSDM-

së, dhe se pa ndihmën e tij nuk do të kishte qenë e mundur "Zhvatja", njofton "Alsat-M". "Zaevi nëpërmjet këtij incizimi dëshmon se nuk ka qenë vetëm kryeministër, por edhe prokuror dhe prokuror special", ka thënë Antonio Milloshoski.



# Kosova dhe Shqipëria ndërmarrin masa për t'u mbrojtur nga koronavirusi

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se ekipet e këtij instituti janë duke përcjell me vëmendje situatën epidemiologjike me koronavirus në botë. Sipas IKShPK-së, në vendin tonë nuk ka koronavirus. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike ka bërë publike edhe masat e parandalimit të këtij virusi. Derisa në Itali raportohet për dy të vdekur dhe mbi 130 të infektuar nga ky virus, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka bërë thirrje që populli shqiptar të mos bie pre e lajmeve të rreme. Ai ka thënë se koronavirusi nuk e ka prekur Shqipërinë dhe ka bërë me dije se janë marrë të gjitha masat në rast shfaqjeje të koronavirusit



**EPOKA ERE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 23 SHKURT** - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShP) ka njoftuar se më 22 shkurt, në orën 20:10, ka marrë informatë nga Klinika Infektive e QKUK-së për dy pacientë të dyshimtë me koronavirus COVID-19. "Pacientët kanë pasur ethe, kollë të thatë të rrallë, lodhje dhe molisje dhe pengesa në frymëmarrje. Dy pacientët u vizituan nga ekipi i infektologëve në

me Shqipërinë, nisur nga fakti që në Itali raportohet për dy të vdekur dhe 132 të infektuar, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka bërë thirrje që populli të mos bie pre e lajmeve të rreme. Ai ka thënë se koronavirusi nuk e ka prekur Shqipërinë, por si për gjithë botën është një kërcënim potencial, për të cilin janë marrë të gjitha masat për t'u përballur me këtë virus. "Mos bini pre e tyre dhe jini të sigurt se shteti shqiptar po e bën prej kohësh detyrën për të qenë gati në rast shfaqjeje të

## Masat e parandalimit

1. Shmangia e kontaktit të ngushtë me njerëzit që vuajnë nga infeksione akute të frymëmarrjes.
  2. Larja e shpeshtë e duarve, veçanërisht pas kontaktit të drejt-përdrejtë me njerëzit e sëmurë ose në vendqëndrimin e tyre.
  3. Shmangia e prekjes së fytyrës dhe mbulimi i gojës dhe hundës me faculetë, me mëngë ose parakrahë gjatë kollës dhe teshtitjes. Hidhni faculetat e përdorura në shportën më të afërt të mbeturinave.
  4. Nëse keni ethe, kollë dhe vështirësi në frymëmarrje kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore dhe tregoni historinë eventuale të udhëtimit jashtë vendit.
  5. Personat e sëmurë duhet të qëndrojnë në shtëpi në mënyrë që të parandalohet përhapja e sëmundjes.
  6. Të evitohen vendet e mbyllura dhe të mbingarkuara me njerëz.
  7. Personat të cilët kanë qenë në provincën Wuhan, Kinë brenda dy javëve të fundit dhe kanë ethe, kollë ose vështirësi në frymëmarrje, duhet menjëherë të kërkojnë ndihmë mjekësore.
  8. Brenda mjediseve të institucioneve të kujdesit shëndetësor, të forcohen praktikat standarde të parandalimit të infeksionit dhe kontrollit në spitale, veçanërisht në shërbimet e urgjencës.
  9. IKShPK rekomandon të gjithë që të mos udhëtojnë drejt Kinës, nëse nuk e kanë të domosdoshme.
- Në rast të ndryshimit apo përkeqësimit të situatës epidemiologjike me koronavirus në Kosovë, rekomandimet mund të pësojnë ndryshime dhe për to do të informoheni me kohë.

për herë të parë në fund të vitit të kaluar, në qytetin Wuhan të Kinës, shkakton infeksion të rëndë akut të frymëmarrjes dhe simptomat zakonisht fillojnë me ethe dhe kollë të thatë. Shifrat e fundit nga

Kina tregojnë për 2 236 njerëz të vdekur dhe mbi 75 000 të infektuar. Koronavirusi është përhapur edhe në pjesën tjetër të Azisë, Evropë, ShBA dhe Afrikë. Aktualisht nuk ka vaksinë për të.



## Masat e shtuara në Rinas dhe në porte për linjat me Italinë

Pasi koronavirusi u shfaq edhe në Itali, njësisia e inspektimit shëndetësor në aeroportin ndërkombëtar të Rinasit në Shqipëri ka ndryshuar protokollin e sigurisë.

Masa e parë që u mor u bë dyfishimi i numrit të stafit mjekësor që punon në aeroportin "Nënë Tereza" në Rinas si dhe u dha udhëzime që të gjithë pasagjerët që vijnë nga Italia do të intervistohen dhe do t'u matet temperatura.

Përfaqësues të njësisë së inspektimit shëndetësor në Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit kanë theksuar se tashmë kanë vendosur termometrin laser që mat temperaturën e njeriut në distancë të afërt, maskat mbrojtëse janë të një cilësie shumë të lartë, që përdoren nga stafi mjekësor, por edhe për t'u dhënë siguri pasagjerëve gjatë intervistimit.

Kontrolle dhe masa të shtuara, përveç në Rinas, janë marrë edhe në portin e Vlorës dhe të Durrësit.



Klinikën Infektive në QKUK të cilëve iu morën mostrat për testim laboratorik në koronavirus SARS-CoV-2 dhe Influenca A dhe B. Mostrat për testim janë sjellë në laborator të Institutit Kombëtar dhe kanë hyrë menjëherë në punë. Ekipi i Laboratorit të Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK ka bërë testimin në koronavirus COVID-19 dhe në influencë A dhe B me metodën rRT-PCR të dy pacientëve. Testi ka përfunduar në orën 00:30 pas mesnate dhe ka rezultuar negativ për të tri analizat, domethënë të dy pacientët nuk janë të infektuar me virusin SARS-CoV-2 dhe as me influenza A dhe B. Ekipet e Institutit Kombëtar po përcjellin me vëmendje situatën epidemiologjike me koronavirus në botë", është bërë me dije në njoftimin e IKShPK-së.

Në një kohë kur koronavirusi duket se është më pranë se kurrë

koronavirusit, të cilin jemi gati ta përbalim me organizim e profesionalizëm të lartë", ka thënë Rama.

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ka reaguar përmes një postimi në llogarinë e vet në "Twitter", ku i bën thirrje Qeverisë së Shqipërisë që të marrë masa serioze dhe të menjëhershme. "Për fat të keq, në Italinë fqinje janë shënuar viktimat e para nga koronavirusi, ndërkohë që po rritet numri i të prekurve prej tij. I kërkoj qeverisë të marrë masa serioze dhe të menjëhershme. U bëj thirrje autoriteteve shëndetësore t'i nisin kontrollet në pikat kufitare. Çdo pikë kontrolli kufitar dhe qendër shëndetësore të pajiset pa asnjë vonesë me personelin dhe aparatet e duhura për ta evidentuar dhe trajtuar në kohë çdo rast të mundshëm", ka shkruar Basha.

Koronavirusi, i cili është shfaqur

FLET PËR “EPOKËN E RE”, NAIM FETAHU

# Do t'i fitoj zgjed

Kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për kryetar të Komunës së Podujevës, Naim Fetahu, beson se do të fitojë më 15 mars. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka thënë se qytetarët e kësaj komune në këto zgjedhje do të votojnë për ndryshim. Fetahu ka deklaruar se Komuna e Podujevës ka nevojë për fitoren e PDK-së. Sipas tij, Podujevës i duhet një qeverisje që në qendër të vet ka interesin e qytetarëve, një qeveri që krijon perspektivë për të rinjtë, siguron drejtësi për punëtorët dhe mbështet bujqit. “20 vjet pas luftës dhe nën udhëheqjen e vetëm një partie, Podujeva sot numëron më së shumti të rinj të papunë, më së paku zhvillim ekonomik, infrastrukturë të rrënuar, qeverisje lokale të kapur dhe të korruptuar, monopol të shërbimeve publike, punësime ekskluzivisht vetëm partiake dhe familjare”, ka thënë ai. Fetahu ka pohuar se të dy kundërkandidatët e tij janë të konsumuar dhe pa ide

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 23 SHKURT** - Kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për kryetar të Komunës së Podujevës, Naim Fetahu, ka shprehur optimizëm për fitoren më 15 mars. Ai ka thënë se kësaj radhe si asnjëherë më parë po vërehet një disponim i mirë i qytetarëve të Podujevës që ta bëjnë ndryshimin e madh në këtë komunë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka thënë se Podujeva ka nevojë për fitoren e PDK-së. “Ne jemi të vendosur për t'i fituar këto zgjedhje dhe do t'a

dalim. Këto ditë kam marrë shumë mesazhe përkrahje nga qytetarët që më herët kanë votuar për LDK-në dhe LV-në. Dhe a dini se çfarë më thonë në takimet e përditshme, se këta vetëm i ndryshojnë partitë për interesa të tyre, por nuk mendojnë për qytetarët. Fitorja e PDK-së është ajo për të cilën ka nevojë Podujeva dhe qytetarët e saj dhe për këtë do të angazhohemi që ta realizojmë”, ka thënë Fetahu. Duke treguar arsytet se pse do të fitojë në zgjedhjet e 15 marsit, ai ka thënë se kjo komunë ka ngecur në të gjitha fushat. “Lajmi i vetëm i cili ka dalë në sipërfaqe nacionale nga kjo

komunë në këto vite ka qenë vendosja e semaforëve. Asgjë tjetër. Zero. Podujeva sot është një nga komunat me më së paku zhvillim. Të rinjtë e Podujevës, të cilët janë shumica e popullsisë, është dashur që të anëtarësohen në LDK që të gjejnë një vend pune. Bujqit, të cilët kanë qenë krenaria e kësaj komune, sot janë lënë anash. Madje shumë fshatra nuk kanë as ujë të pijshëm e as rrugë të denja për të kaluar”, është shprehur Fetahu.

Në këtë intervistë kandidati i PDK-së për kryetar të Podujevës ka thënë se dy kundërkandidatët e tij janë të

konsumuar dhe pa ide. “E gjitha që unë i kam dhënë Podujevës dhe Kosovës, kanë qenë vitet e mia më të mira në luftën për liri dhe rindërtimin e vendit në pozita të ndryshme ekzekutive që kam pasur në nivel qendror. Prandaj, po e përsëris, qytetarët e Podujevës i dinë këto gjëra dhe do t'i shfrytëzojnë këto zgjedhje për t'i larguar kapësit e qytetit nga pushteti”, është shprehur Fetahu.

**“Epoka e re”:** Z. Fetahu, sa është përgatitur PDK-ja dhe ju si kandidat për zgjedhjet në Komunën e Podujevës?

**Fetahu:** Partia Demokratike e

Kosovës në vazhdimësi ka qenë në kontakt me strukturat e saj në mbarë vendin. Ka organizuar rregullisht aktivitete dhe është gjithmonë aktive, pavarësisht a është në pushtet apo në opozitë. Kontakti me qytetarin është primare, sidomos për degën e PDK-së në Podujevë e cila është në opozitë. Prandaj, zgjedhjet e parakohshme në Podujevë, Partinë Demokratike të Kosovës, por edhe mua si kryetar i Degës së PDK-së në Podujevë dhe kandidat për kryetar të komunës, na gjejnë të gatshëm dhe të përgatitur për të fituar në zgjedhjet e 15 marsit. Kësaj radhe po vërehet,

# hjet në Podujevë

**Fetahu:** PDK-ja do t'i fitojë zgjedhjet në Komunën e Podujevës më 15 mars dhe do t'uj tregoj pse. Në vitin 2013, kur unë kam kandiduar për herë të parë për kryetar të Komunës së Podujevës, kam marrë mbi 15 mijë vota dhe vetëm për më pak se 100 vota isha afër balotazhit. Por, shikoni se çfarë ka ndodhur nga viti 2013 në Podujevë. Lajmi i vetëm i cili ka dalë në sipërfaqe nacionale nga kjo komunë në këto vite ka qenë vendosja e semaforëve. Asgjë tjetër. Zero. Podujeva sot është një nga komunat me më së paku zhvillim. Të rinjtë e Podujevës, të cilët janë shumica e popullsisë, është dashur që të anëtarësohen në LDK që të gjejnë një vend pune. Bujqit, të cilët kanë qenë krenaria e kësaj komune, sot janë lënë anash. Madje shumë fshatra nuk kanë as ujë të pijshëm e as rrugë të denja për të kaluar. E si po mendojnë LDK-ja dhe Vetëvendosja t'i ndryshojnë këto gjëra? Me ish-drejtorë të Agim Veliut që janë pikërisht përgjegjës për këtë gjë. Jo, qytetarët e Podujevës i dinë këto probleme dhe nuk i harrojnë dëmet që qeverisja e LDK-së në këtë komunë ua ka bërë qytetarëve. Prandaj, më 15 mars ata do të votojnë për ndryshim.

**"Epoka e re":** E keni menduar si variant që të punoni bile edhe për balotazh, që ta përjashtoni njërin prej kandidatëve?

**Fetahu:** Ne jemi të vendosur për t'i fituar këto zgjedhje dhe do t'ia dalim. Këto ditë kam marrë shumë mesazhe përkrahje nga qytetarët që më herët kanë votuar për LDK-në e LV-në. Dhe a dini se çfarë më thonë në takimet e përditshme, se këta vetëm i ndryshojnë partitë për interesa të tyre, por nuk mendojnë për qytetarët. Fitorja e PDK-së është ajo për të cilën ka nevojë Podujeva dhe qytetarët e saj dhe për këtë do të angazhohemi që ta realizojmë.

**"Epoka e re":** Ku dalloni ju nga dy kandidatët tjetër, z. Rudari dhe Bulliqi?

**Fetahu:** Unë nuk kam qenë asnjëherë drejtor i Agim Veliut. E dyta, nuk jam përgjegjës për as edhe një të keqe, e të cilat

janë shumë, që i kanë ndodhur qytetit tonë në këto 20 vjet. Po ashtu, unë nuk jam përgjegjës as për mosliberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës, sepse asnjëherë nuk kam promovuar kauza të cilat dolën të jenë të rrejshme për territorin e vendit sikur ka bërë Shpejtim Bulliqi. Dy kundërkandidatët e mi nuk mund ta thonë të njëjtën gjë. Të dy janë të konsumuar dhe pa ide. E gjitha që unë i kam dhënë Podujevës dhe Kosovës, kanë qenë vitet e mia më të mira në luftën për liri dhe rindërtimin e vendit në pozita të ndryshme ekzekutive që kam pasur në nivel qendror. Prandaj, po e përsëris, qytetarët e Podujevës i dinë këto gjëra dhe do të shfrytëzojnë këto zgjedhje për

t'i larguar kapësit e qytetit nga pushteti.

**"Epoka e re":** Cili është vlerësimi juaj për qeverisjen në Podujevë për këto vite?

**Fetahu:** 20 vjet pas luftës dhe nën udhëheqjen e vetëm një partie, Podujeva sot numëron më së shumti të rinj të papunë, më së paku zhvillim ekonomik, infrastrukturë të rrënuar, qeverisje lokale të kapur dhe të korruptuar, monopol të shërbimeve publike, punësime ekskluzivisht vetëm partiake dhe familjare etj. Podujeva nuk i duron më këto gjëra. Podujeva nuk e lejon më këtë qeverisje. Podujeva është lodhur nga mashtruesit dhe përfituesit dhe më 15 mars do t'ua japë atyre përgjigjen e merituar.

**"Epoka e re":** Çfarë ndryshimesh i duhen qytetit të Podujevës? Çfarë përmban platforma juaj qeverisëse?

**Fetahu:** Podujevës i duhet një qeverisje që në qendër të vet ka interesin e qytetarëve, mirëqenien e tyre dhe përmirësimin e kushteve të jetesës, që krijon perspektivë për të rinjtë, siguron drejtësi për punëtorët, mbështet bujqit, kujdeset për të moshuarit dhe e shkapë komunën nga nepotizmi dhe politika partiake duke ua kthyer atë qytetarëve. Do t'i rikthejmë vitet e arta për sportin dhe kulturën, që dikur kanë qenë krenaria e qytetit tonë. Kjo është ajo për të cilën unë dhe qeverisja ime do të angazhohemi dhe do ta realizojmë.



## Presidenti Thaçi niset për në ShBA, do të ketë takime me administratën amerikane

**PRISHTINË, 23 SHKURT (ER)** - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka udhëtuar të dielën për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku do të takojë zyrtarë të lartë të administratës amerikane.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë rikthyer vëmendjen në zhvillimet në Kosovë dhe në rajon, duke u angazhuar për arritjen e marrëveshjes përfundimtare të paqes në mes të Kosovës dhe Serbisë si dhe për t'u hapur rrugë investimeve nga jashtë

dhe zhvillimit ekonomik. Para nisjes për në ShBA, presidenti Thaçi u shpreh se "Kosova është me fat që Shtetet e Bashkuara të Amerikës ruajnë përkushtimin për Kosovën, për paqen, stabilitetin dhe prosperitetin e Kosovës dhe tërë rajonit". "Lidershipi i presidentit Trump, përkrahja e sekretarit Pompei dhe angazhimi i drejtpërdrejtë i të dërguarit special, ambasadorit Grenell, janë inkurajim për ne", u shpreh Thaçi. "Jemi të bekuar me miqësinë tonë të përhershme, me raportin tonë special me

Shtetet e Bashkuara të Amerikës", ka shtuar presidenti Thaçi.

Presidenti Thaçi në Uashington do të ketë prezantime edhe në dy debate për zhvillimet në Kosovë dhe rajon, një në Brookings Institute dhe tjetrin në Atlantic Council, si dhe do të ketë takime në think-tanks me ndikim në politikën e jashtme të ShBA-së. Presidenti Thaçi do të flasë për të arriturat e deritashme, për prioritetet e Kosovës dhe për sfidat e mundësitë në rrugën e integritimit euroatlantik.

si asnjëherë më parë, një disponim i mirë edhe i qytetarëve të Podujevës që ta bëjnë ndryshimin e madh për qytetin e tyre. Në Podujevë është rritur dhe tashmë është e gatshme për të votuar, një gjeneratë e re e popullsisë, e cila për 20 vjet nuk ka parë as edhe një ndryshim pozitiv në qytet. Ka ardhur koha që së bashku me qytetarët ta ndryshojmë këtë gjendje të mjerueshme dhe status quo.

**"Epoka e re":** Dihet se Podujeva është bastion i LDK-së dhe LV-ja është shumë afër LDK-së me vota. Sa janë gjasat që PDK-ja t'i fitojë zgjedhjet?

# Haradinaj kërkon mbajtjen e taksës, Mustafa heqjen e saj

Kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, i është shtuar presioni për taksën nga lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj dhe ai i LDK-së, Isa Mustafa. I pari po kërkon nga Qeveria e Kosovës të mos e heqë taksën 100 për qind ndaj mallrave serbe, kurse i dyti, që Kurtin e ka partner qeverisës, ka kërkuar që Kosova në përputhje me kërkesën e ShBA-së dhe BE-së duhet ta heqë taksën sa më shpejt



**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 23 SHKURT - Kryeministri Albin Kurti po përballet me kërkesa të ndryshme nga faktori politik vendor për çështjen e taksës 100 ndaj produkteve serbe. Ndryshe nga ndërkombëtarët dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), që po kërkojnë heqjen e kësaj takse, ish-kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, i ka bërë thirrje qeverisë që ta mbajë atë. Lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka deklaruar se heqja e taksës do ta sillte pushtimin ekonomik të Kosovës nga Serbia. "Kosova nuk ka asnjë garanci se heqja e taksës 100 për qind për produktet e Serbisë e sjellë marrëveshjen finale për njohjen reciproke në kufijtë ekzistues. Sot Serbia vazhdon të armatoset nga Rusia me pajisjet me të reja ushtarake, ndërsa qeveria Kurti

premtion heqjen e taksës duke siguruar pushtimin ekonomik të Kosovës nga Serbia. I bëj thirrje publike Kurtit dhe partnerëve të tij qeverisës që mos të hiqet taksa pa njohje. Pushtetet nuk janë asgjë kur janë në pyetje ruajtja dhe mbrojtja e sovranitetit të vendit. Tregu vetëm për njohje", ka shkruar Haradinaj në profilin e vet në "Facebook".

Ndërsa lideri i LDK-së, Isa Mustafa, si partner qeverisës e ka sugjeruar kryeministrin Kurti që sa më shpejt ta heqë taksën. Në profilin vet në "Facebook", Mustafa ka shkruar se në programin qeverisës të harmonizuar me Lëvizjen Vetëvendosje janë orientuar për heqjen e tarifës dhe zbatimin e masave reciproke me Serbinë, për çfarë nuk janë përcaktuar modalitetet e reciprocitetit dhe renditja e hapave. "Kosova duhet të heqë tarifën, në mirëbesim

me ShBA-në dhe BE-në; Kosova duhet t'i njoftojë partnerët tanë për të gjitha pengesat ekonomike, tregtare dhe politike, të cilat në periudhën në vazhdim duhet t'i heqë Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina, në mënyrë që pengesat reciproke të jenë zero; Vendet e BE-së do të duhej ta hiqnin 'tarifën e izolimit të qytetarëve të Kosovës'. Nëse Serbia, në kohën që ne e bashkërendisim me mirëkuptim me partnerët tanë, nuk eviton pengesat, atëherë Kosova duhet t'i aktivizojë masat e reciprocitetit", ka shkruar

Mustafa. Sipas tij, rezultati që duhet të synojë Kosova në këtë proces është njohja reciproke, e cila përfundimisht do t'i zgjidhë edhe problemet e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar me Serbinë dhe krijon ambient të sigurt dhe pozitiv për investime të jashtme. "Konsideroj se na ndihmon bashkëpunimi i ngushtë me LV-në, si partnerë të koalicionit, dhe marrja e përgjegjësive të përbashkëta që ta menaxhojmë këtë proces duke u bërë kjo qeveri prijatë e zgjidhjes në kohën e duhur. Opozita gjithëherë

ka kërkuar rol të fuqishëm të ShBA-së dhe efikasitet të BE-së. Në horizont është edhe njëra edhe tjetra", ka shkruar Mustafa. Edhe kryeministri Albin Kurti ka paralajmëruar zëvendësimin e taksës me reciprocitet të plotë. Ai deri më tani nuk ka treguar për modalitetin e aplikimit të këtij parimi dhe për kohën se kur do të mund të fillojë zbatimi i tij. Prej fillimit të mandatit, qeveria e re është përballur me presionin e ShBA-së dhe të BE-së për heqjen e taksës dhe rifillimin e fazës finale të procesit të dialogut Kosovë - Serbi.

## Haxhiu: Noterët, përmbauesit dhe ndërmjetësuesit s'do t'i lejojmë të abuzojnë me detyrat e tyre



PRISHTINË, 23 SHKURT (ER) - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka thënë se kjo ministri e ka për obligim ta mbikëqyrë punën e noterëve, përmbauesve dhe ndërmjetësuesve. Ajo ka thënë se nuk do të tolerojë që noterët, përmbauesit dhe ndërmjetësuesit të abuzojnë me detyrat e tyre. "Ministria e Drejtësisë e ka për obligim ta

mbikëqyrë punën e noterëve, përmbauesve dhe ndërmjetësuesve. Gjatë këtyre ditëve kam parë shqetësime të qytetarëve lidhur me shkeljen e detyrave nga disa përmbaues dhe noterë. U lutem të gjithëve që secilën ankesë ta formalizojnë e procedojnë në Ministri të Drejtësisë. Secilën ankesë do ta adresojmë dhe nuk do ta neglizhojmë sikur ka

ndodhur në të kaluarën. Secili prej nesh, përfshirë edhe përmbauesit dhe noterët, duhet të veprojmë vetëm në bazë të ligjit dhe nuk duhet të ketë tejkallim të kompetencave. Tejkallimin e kompetencave, abuzimin e tyre apo moszbatimin e detyrave, nuk do ta tolerojmë", ka shkruar Haxhiu në llogarinë e vet në "Facebook".

## Kjo javë në Kosovë do të jetë me diell

Prishtinë, 23 shkurt (ER) - Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës ka njoftuar se java e fundit e muajit shkurt do të karakterizohet me mot relativisht të butë, me diell dhe vranësira të cilat nga pasditja e së mërkurës dhe ditën e enjte parashihen të shoqërohen me reshje shiu dhe bore. "Të mërkurën, natën vonë dhe të enjten, pos reshjeve, parashihet të ketë edhe erëra

të fuqishme të cilat, si zakonisht, më të theksuara do të jenë në veri të Dukagjinit. Temperaturat minimale do të lëvizin ndërmjet -3 deri 3 gradë celsius, ndërsa maksimalet e ditës parashihen të lëvizin ndërmjet 5-14 gradë celsius. Këto temperatura negative do të krijojnë ngrica të dobëta në orët e para të ditës dhe kërkohet kujdes nga pjesëmarrësit në trafik, sidomos në viset kodrinore-malore, ku prania e diellit është më e kufizuar. Do të fryjë erë nga drejtimi i jugperëndimit dhe veriperëndimit, e lehtë deri e fuqishme", është bërë me dije në njoftimin e IHMK-së. Sipas këtij njoftimi, situata biometeorologjike do të jetë relativisht e mirë për shkak të pranisë së këtyre elementeve dhe dukurive meteorologjike gjatë kësaj periudhe

mos në viset kodrinore-malore, ku prania e diellit është më e kufizuar. Do të fryjë erë nga drejtimi i jugperëndimit dhe veriperëndimit, e lehtë deri e fuqishme", është bërë me dije në njoftimin e IHMK-së. Sipas këtij njoftimi, situata biometeorologjike do të jetë relativisht e mirë për shkak të pranisë së këtyre elementeve dhe dukurive meteorologjike gjatë kësaj periudhe



pesëditëshe të parashikimit. "Në bazë të parashikimeve afatgjate muaji mars premtion

reshje të bollshme atmosferike", theksohet në këtë njoftim.

# Totaj: Qeveria Kurti ka filluar një spastrim me agjendë politike brenda institucioneve të Kosovës

**EPOKA E RE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 SHKURT - Nënkrjetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Shaqir Totaj dhe zëdhënësi i PDK-së, Avni Bytyçi, kanë mbajtur të dielën konferencë për media për zhvillimet e fundit politike në vend, duke kritikuar ashpër kryeministrin Albin Kurti, i cili, sipas tyre, edhe pas pesë muajve nga zgjedhjet e 6 tetorit, ende nuk ka ofruar një program qeverisës. “Në mungesë të një vizioni të qartë, z. Kurti si kryeministër ka ndërmarë veprime që sulmojnë në thelb administratën e pavarur të shtetit. Për Partinë Demokratike janë të kuptueshme dhe të pranueshme veprimet ligjore e që kanë për qëllim mbrojtjen e institucionit. Mirëpo, është më se e qartë se kjo qeveri nën petkun kinse të ligjshmërisë ka filluar një spastrim me agjendë politike brenda institucioneve të Republikës së Kosovës. Shembull është rasti i drejtorit të doganave, që kishte ardhur në këtë pozitë pas një konkursi transparent dhe të mbikëqyrur nga Ambasada Britanike, madje në kohën sa në krye të Ministrisë së Financave ishte LDK-ja”, ka



thënë nënkryetari i PDK-së, Shaqir Totaj. Ai ka bërë me dije se ky veprim i kryeministrit Kurti ka qenë i paligjshëm dhe i dëmshëm për Doganën. “Ne ftojmë këtë qeveri që t’i mbajë duart larg nga institucionet e pavarura dhe individët të cilët deri më tani janë shquar për sukses dhe ku shteti i Kosovës ka investuar me vite në ta”, ka thënë Totaj, i cili ka ngritur

shqetësimin se kryeministri i ri u ka dhënë direktiva ministrave në kundërshtim me ligjin që të kujdesen për proceset e përzgjedhjes së kandidatëve në shërbimin civil, përderisa kjo çështje është e rregulluar me ligj. “Këtë situatë e rëndojnë më shumë deklaratat e eksponentëve të Lëvizjes Vetëvendosje që publikisht kanë ftuar për të ndërhyrë në

institucione të pavarura duke kërkuar me emra të përveçëm shkarkime e linçime. Madje në institucionet më të besueshme të vendit, siç është Policia e, ndoshta, nesër edhe FSK-ja. Deputeti i Vetëvendosjes, Sali Zyba, ka bërë ftesë publike që të largohet drejtoresha e Inspektoratit Policor. Përderisa Fitore Pacolli, po ashtu, kishte kërkuar shkarkimin e

ambasadores Vlora Çitaku”, ka thënë Totaj.

Nga ana e tij, zëdhënësi i PDK-së, Avni Bytyçi, ka deklaruar se këto veprime antiligjore të Kurtit vijnë pasi ai ende nuk ka një plan qeverisës. “Dhe si rezultat ne e kemi një qeveri pa një orientim të qartë, e cila veprimet i bazon në populizëm, duke e imponuar mentalitetin improvizues. Pa një plan të qartë e pa propozime konkrete deri më tani për buxhetin, Qeveria e Kosovës e ka reduktuar rolin e saj vetëm në akte ad-hoc-e dhe vendime populiste”, është shprehur zëdhënësi i PDK-së, Avni Bytyçi, duke shtuar se Qeveria Kurti, përpos mungesës së programit qeverisës, ka mungesë edhe të kohezionit të brendshëm me partnerin e koalicionit. “Si e tillë, kjo qeveri flet me dy apo më shumë qëndrime, që thellon edhe më shumë paqartësitë. Moskoordinimi në mes të LV-së dhe LDK-së krijon paqartësi te qytetarët e Republikës së Kosovës dhe partnerët tanë ndërkombëtarë, me theks të veçantë te Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Për Partinë Demokratike të Kosovës këto dy raporte janë të domosdoshme për të ardhmen e mirë të vendit”, ka thënë Bytyçi.

## Rikthehen sulmet me vezë ndaj zyrtarëve të shtetit

**EPOKA E RE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 23 SHKURT - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), është sulmuar me vezë nga një qytetar të shtunën pranë objektit të Qeverisë së Kosovës. Në një video të shpërndarë në rrjetet sociale dëgjohet një person duke thënë “taksën nuk bën me e heq”, duke iu referuar tarifës 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë, të cilën kryeministri i ri i Kosovës, Albin Kurti, tha se do ta zëvendësojnë me reciprocitet të plotë. Ndaj këtij veprimi ka reaguar kryeministri Albin Kurti, i cili ka thënë se veprimet e dirigjuara prej marazit të ngelur nga 6 tetori e 3 shkurti nuk e shqetësojnë qeverinë, e cila po punon e angazhohet për të mirën e popullit e të shtetit dhe mbështetet gjerësisht nga

qytetarët. “Zëvendëskryeministrit Hoti i uroj forcë e punë të mbarë, opozitës i dëshiroj frymë bashkëpunuese, edhe kur e luftojmë korrupsionin e krimin, edhe kur e mbrojmë shtetin e kombin”, ka thënë Kurti në reagimin e tij. Edhe presidenti Hashim Thaçi ka thënë se sulmi me vezë ndaj zëvendëskryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti, është i papranueshëm dhe i dënueshëm në demokracinë dhe shtetin që kemi ndërtuar. “Tendenca për ta arsyetuar dhunën si mjet për arritjen e qëllimeve politike ka qenë dhe do të mbetet përherë e papranueshme dhe e dënueshme”, ka thënë Thaçi. Edhe kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, e ka dënua këtë veprim. “Tarifa nuk është çështje vezësh. Është konsensus e veprim shtetëror dhe bashkërendim me miqtë strategjikë të Kosovës. As sulmet



me vezë e as me mjete të tjera nuk do të mund ta ndalin vendosmërinë tonë që ta çojmë Kosovën përpara”, ka thënë Osmani në reagimin e saj. Sulmin me vezë ndaj zëvendëskryeministrit Hoti e ka dënua edhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). Kjo parti përmes një komunikate për media e ka quajtur sulmin “akt të ulët të

papranueshëm dhe të dëmshëm për proceset vendimtare nëpër të cilat po kalon vendi”. “Është i papranueshëm kthimi i shoqërisë sonë në sulme të këtilla, njësoj si në vitet 2015-2016, me qëllim stagnimin dhe bllokimin e proceseve shtetformuese që i kemi ndërtuar në partneritet me miqtë tanë ndërkombëtarë. Kosova ka nevojë për qetësi, maturi dhe unitet në politikbërje dhe udhëheqje të vendit”, është thënë në reagimin e LDK-së. Këtë sulm të Hotit ndryshe e ka komentuar opozita. Anëtar i Kryesisë së Nismës Socialdemokrate, Fazli Hoxha, ka thënë se gjuajtja me vezë është shkollë që ka praktikuar Lëvizja Vetëvendosje. “Nuk po dua të mbroj askënd për veprimin me vezë ndaj zëvendëskryeministrit Avdullah Hoti, por po më çuditë një postim në ‘Facebook’ i deputetes Arbërie Nagavci, e cila paska

deklaruar: ‘Të gjuash me vezë nuk të bën në vetvete opozitar. Opozitarizmi duhet të jetë i bazuar në fakte e argumente, me dhënie të propozimeve e ideve alternative’. Pra, nuk qenka mirë të gjuash dikë me vezë, a? E për ju LV-në paska qenë mirë atëherë kur gjuanit me vezë sa ishit në opozitë?! Po më vjen mirë që tash po e kuptoni se opozita nuk bëhet me vezë, por me fakte e argumente. Çka të bëjmë tash?! Këtë shkollë të vezëve ju e keni qitë në dritë e tash durojeni”, ka shkruar Fazli Hoxha në llogarinë e vet në “Facebook”. Kjo lloj praktike për të gjuajtur me vezë është nisur nga Lëvizja Vetëvendosje. Deputetët e saj në vitin 2015, në muajin shtator e kishin gjuajtur me vezë në Kuvend kryeministrin e atëherëshëm Isa Mustafa, i cili po mbante një fjalim. Gjuajtja me vezë nga LV-ja ka vazhduar edhe në vitin 2016.

# Koronavirusi ndikon në rënien e blerjeve online nga Kina

PRISHTINË, 23 SHKURT - Kosova ka ndaluar mallrat që dyshohet se bartin koronavirusin e ri, Covid-19, të cilat kanë origjinën nga Kina, thonë zyrtarë të Doganave të Kosovës dhe Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit të Kosovës (AVUK). Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, gjatë vitit 2018 Kosova ka eksportuar mallra në Kinë në vlerë rreth 1.4 milion euro, kurse ka importuar në vlerë rreth 312 milionë euro. Lamir Thaçi, zëdhënës në Agjencinë e Veterinës dhe Ushqimit të Kosovës, i tha "Radio Evropa e Lirë" se produktet e vlerësuar si të rrezikshme për bartjen e virusit janë ndaluar të importohen. Ai thotë se produktet të cilat janë ndaluar të hyjnë në Kosovë nga Kina janë kryesisht prodhime me origjinë shtazore. "AVUK prej momentit të parë të shfaqjes së koronavirusit në Kinë ka ngritur nivelin e kontrollit dhe kemi identifikuar produktet që kanë qenë duke u importuar në Kosovë. Pra, bëhet fjalë për produkte me origjinë shtazore dhe nga të dhënat që ne kemi, kemi gjetur se në Kosovë importohet vetëm ushqimi për bletë dhe hojet e bletëve. Ne kemi marrë masën e ndalesës për këtë produkt. Vetëm

produktet me origjinë shtazore janë vlerësuar fillimisht si materie përmes të cilave mund të bartet ky virus dhe ndalesa është marrë me kohë", ka thënë Thaçi.

Ai thotë se tashmë është caktuar edhe personi përgjegjës për luftimin e sëmundjeve ngjitëse, me theks të veçantë në masat kundër koronavirusit të ri. "Tash kemi përcaktuar një person kompetent i cili është në grupin e luftimit për sëmundje ngjitëse, posaçërisht për koronavirusin e ri dhe të gjitha veprimet që kërkohen nga ky grup ne jemi të gatshëm t'i zbatojmë, pasi kemi përvojë edhe nga luftimi i sëmundjeve të tjera infektive që e kanë prekur shëndetin veterinar", ka thënë ai.

Lloji i ri i koronavirusit shkakton sëmundje akute të frymëmarrjes, e cila është emëruar Covid-19 dhe për herë të parë është shfaqur në qytetin Vuhan të Kinës në muajin dhjetor. Shifrat e fundit nga Kina tregojnë për më shumë se 2 200 njerëz të vdekur dhe mbi 75 000 të infektuar.

Në Doganën e Kosovës, zëdhënësi Adriatik Stavileci ka thënë se rënia e importit nga Kina, ku e dhe e ka origjinën koronavirusi i ri Covid-19, është vërejtur në blerjet online. Nëse



krahasohet periudha e njëjtë e vitit të kaluar me periudhën e këtij viti, sipas tij, vërehet se ka rënie të blerjeve online nga Kina deri në 35 për qind. "Ndalesat e importit nga Kina tashmë i ka dërguar AVUK-u dhe ne kemi marrë masa menjëherë. Sidoqoftë, niveli i importit është herët që të përcaktohet, meqë porositë nga Kina bëhen kryesisht deri në dy muaj më herët. Andaj efektet do të shihen më vonë", është shprehur Stavileci.

Ndërkaq qytetarët e anketuar

nga "Radio Evropa e Lirë", të cilët tashmë kanë përvojë me blerjet online nga Kina, thonë se prej kur është paraqitur koronavirusi i ri i kanë ndërprerë porositë e tyre përmes internetit.

Besa, një 24-vjeçare nga Prishtina, thotë se ka porositur produkte nga Kina, por që nga paraqitja e këtij virusi ajo tashmë nuk porosit. "Deri para një muaji kam porositur në njërin nga sajtet, në 'Aliexpress', e që e ka bazën në Kinë. Por e kam ndërprerë për shkak se frikësohem nga virusi. Zakonisht

kam porositur gjëra të vogla, si vathë, aksesorë të ndryshëm, çanta apo të ngjashme, jo edhe rroba. Prej kur është lajmëruar koronavirusi i ri i kam ndërprerë porositë", ka thënë ajo.

Përveç Kinës, ku edhe ishte burimi i virusit të ri, edhe në rreth 30 shtete të tjera janë regjistruar më shumë se 500 raste me koronavirusin e ri. Katër veta kanë vdekur jashtë Kinës: në Francë, Hong Kong, Filipine dhe Japoni.

Në Kosovë nuk është paraqitur ende asnjë rast me këtë virus.

## Abdixhiku kërkon anulimin e projektit të ndërtimit në liqenin e Badovcit



PRISHTINË, 23 SHKURT (ER) - Ministri i Infrastrukturës dhe Ambientit, Lumir Abdixhiku, ka bërë me dije, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", se ka kërkuar anulimin e vendimit për kushtet ndërtimore të një lagjeje në afërsi të Badovcit. Muaj më parë

ishin bërë të ditura planet për krijimin e një lagjeje luksoze afër liqenit të Badovcit që kishte nxitur reagime të shumta nga mijëra përdorues të rrjeteve sociale.

Abdixhiku ka thënë se Qeveria e Kosovës është e përkushtuar t'i mbrojë resurset natyrore të

vendit dhe ta dëgjojë aktivizmin qytetar. "Duke u thirrur në Ligjin për Ujërat e Kosovës, mbështetur në vendimin e qeverisë për zonat e mbrojtura në liqenin e Badovcit, Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit ka obliguar Komunën e Prishtinës që ta bëjë anulimin e

vendimit për kushtet ndërtimore për rastin e lagjes në afërsi të Badovcit. Qeveria e Kosovës është e përkushtuar t'i mbrojë resurset natyrore të vendit. Mbi të gjitha, është e interesuar ta dëgjojë zërin e padëgjuar të aktivizmit qytetar, që këtë herë ishte përcaktues në

ngritjen e alarmit me kohë", ka shkruar ai.

Qytetarët kishin nënshkruar një peticion online duke iu kërkuar autoriteteve llogari për ndërtimin e kësaj lagjeje. Ndërkaq, zyrtarë të institucioneve kishin mohuar të kenë dhënë leje për këtë projekt.



# As taksë, as reciprocitet, por ambient të barabartë afarist



Prime Minister Office/Press release (Official publication)

PRISHTINE, 23 SHKURT - Disa nga bizneset prodhuese në Kosovë thonë se nuk janë as në favor të mbajtjes së taksës 100 për qind të vendosur nga qeveria e kaluar për importet nga Serbia e Bosnje e Hercegovina, por as për reciprocitet. Këto biznese thonë se janë në favor të një ambienti afarist ku ka konkurrencë të barabartë dhe të drejtë.

Qeveria e kaluar në nëntor të vitit 2018 pati vendosur taksën doganore 100 për qind për importet nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina, por kjo taksë po shqyrtohet aktualisht nga qeveria e re e kryeministrit Albin Kurti, që të zëvendësohet me reciprocitet të plotë politik, ekonomik dhe tregtar ndaj Serbisë.

Bedri Kosumi, pronar i kompanisë "Pestova", që merret me përpunimin dhe prodhimin e patates, tha për "Radion Evropa e Lirë" se si prodhuesit kërkojnë të jenë të barabartë në treg dhe asgjë më shumë. "Si prodhues nuk kërkojmë asgjë tjetër vetëm të jemi të barabartë. Nëse dikush ka të drejtë ose barkodi i një shteti tjetër të jetë prezent në Kosovë, e njëjta gjë duhet të vlejë edhe për neve, të pranohet edhe barkodi dhe produktet tonë të lejohen të jenë në atë shtet. Ne nuk i frikësohemi konkurrencës, por kërkojmë të jemi të barabartë.

Produktet e Serbisë nuk janë as më të mira e as më të lira, por e vërteta është se barkodi i Serbisë pranohet në Kosovë, ndërkaq nëse ne dëshirojmë t'i shesim në Serbi, produktet tona, barkodi që është 039 dhe si shenjë identifikuese e Kosovës, nuk lejohet në Serbi", është shprehur Kosumi.

Gjatë kësaj jave kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në Konventën e Prodhuesve të Kosovës ka theksuar se tarifa 100 për qind do të hiqet dhe do të zbatohet reciprociteti i plotë tregtar me Serbinë. Kurti ka thënë se qeveria që ai udhëheq nuk është për tarifa si masë ndëshkuese ndaj konsumatorit, por për reciprocitet si masë mbrojtëse ndaj prodhuesve. "Produktet që prodhohen në Kosovë, e të cilat iu nënshtrohen praktikave dhe konkurrencës jolojale, do të mbrohen. Parimet e reciprocitetit që do të nxirren nga Qeveria e Kosovës do të jenë të bazuara në parimet e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) dhe në CEFTA", ka thënë Kurti, duke shtuar se qeveria e tij nuk do të marrë vendim për ekonominë e prodhimit pa diskutuar dhe konsultuar prodhuesit.

Kryeministri Kurti ka thënë se porsa t'i marrë rekomandimet e grupit punues, i përbërë nga institucionet dhe përfaqësuesit

e bizneseve, që do t'i përmbledhin të gjitha barrierat tregtare me Serbinë, do t'i analizojnë rekomandimet dhe do të marrin vendim për largim të tarifës dhe vendosjen e reciprocitetit.

Sylejman Konushevi, pronar i fabrikës së vajit "Inter-company" nga Podujeva, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se do të donin që qeveria e re të arrinte të krijonte një ambient afarist të mirë për bizneset prodhuese dhe të barabartë në treg. "Në kushte normale, sikur të ishte Serbia një shtet i cili do të ishte një fqinj i mirë dhe i cili do ta njihje pavarësinë e Kosovës, nuk do të kishte nevojë as për taksë e as për reciprocitet. Por, duke pasur parasysh sjelljen e Serbisë në raport me Kosovën, taksë ka qenë e mirë për ne prodhuesit, pasi që Serbia me një ekonomi të fortë na ka dëmtuar. Po ashtu, Serbia nuk ka respektuar asnjë marrëveshje tregtare siç është edhe CEFTA. Prodhimet serbe të cilat kanë ardhur në Kosovë kanë pasur mbështetje dhe stimulim nga shteti i Serbisë", ka theksuar Konushevi.

Ai tregon se ka pasur raste të shumta kur i kanë eksportuar produktet e tyre në Serbi, por atje problemi ishte me mosnjohjen e dokumentacionit të Kosovës, kështu që kanë hasur në barrierë

të shumta tregtare. "Kemi pasur raste kur kemi eksportuar produkte në Serbi, maunat tona kanë qëndruar deri në 20 ditë në terminal të Serbisë dhe e kanë dërguar mallin në analiza të shumta, duke e penguar dhe duke vendosur barrierë në mënyrë që të mos lejojnë mallin tonë të hyjë në tregun e tyre", është shprehur Konushevi.

Heqjen e taksës 100 për qind për produktet me origjinë nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina e kanë kërkuar edhe përfaqësuesit e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK).

Drejtori ekzekutiv i OEAK-ut, Arian Zeka, pati thënë për "Radion Evropa e Lirë" se është e nevojshme që tarifa të hiqet pasi që është në kundërshtim me frymën e zotimeve që Kosova ka ndërmarrë në raport me shtetet e tjera. "Tarifa, si e tillë, duhet të rishqyrtohet dhe të hiqet menjëherë nga ana e qeverisë së re ashtu që të mund të kalojmë në një fazë tjetër ku diskutohet për raporte të reja, edhe tregtare, edhe çfarëdo lirie tjetër që mund të diskutohet. Duhet të flasim për eliminimin e të gjitha problemeve të natyrës politike që kanë ekzistuar në të kaluarën, të cilat pastaj do të mundësonin edhe njohjen e dokumentacionit, edhe njohjen e procedurave të plota që lëshohen nga njëri shtet dhe njihen nga shteti tjetër", ka

thënë Zeka.

Që nga vendosja e taksës 100 për qind për produktet e importuara nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina importi nga këto shtete ka rënë për 99 për qind. Para vendosjes së taksës doganore, Serbia ishte eksportuesja më e madhe e produkteve në Kosovë. Ky shtet, para 21 nëntorit të vitit 2018 - kur u vendos taksë 100 për qind - gjatë një dite ka eksportuar në Kosovë mallra në vlerë rreth 1.2 milion euro apo rreth 450 milionë euro brenda një viti.

Taksë 100 për qind për importet nga Serbia ka ndikuar që dialogu për normalizimin e raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të ndërpritet. Kundër kësaj takse, që nga vendosja e saj, ish-indeklaruar Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian.

Ndërkaq kohët e fundit, pas formimit të qeverisë së re, presioni diplomatik mbi Prishtinën zyrtare, që ta shfuqizojë vendimin për taksën, është rritur, me synim që edhe dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë të vazhdojë deri në arritjen e një marrëveshjeje paqësore mes dy vendeve. Shtetet e Bashkuara po kërkojnë nga Prishtina që pas heqjes së taksës të mos vendosë barrierë të tjera, përfshirë edhe masën e reciprocitetit.

## GAP-i: Nga 903 premtime, komunat kanë përmbushur vetëm 304

PRISHTINË, 23 SHKURT (ER) - Instituti GAP në platformën elektronike "Letërnjoftimi i komunave" ka publikuar përparimin e kryetarëve të komunave për përmbushjen e premtimeve të dhëna në zgjedhjet e fundit lokale të vitit 2017. Sipas GAP-it, nga gjithsej 903 premtime të evidentuara deri në muajin dhjetor 2019, komunat kanë përmbushur 304 premtime, 171 premtime rezultojnë gjysmë të përmbushura, 233 premtime kanë filluar të përmbushen ose ka nisma në përmbushjen e tyre, ndërsa për 195 premtime nuk është evidentuar ndonjë nismë komunale në përmbushjen e tyre. "Fushat ku ka përparim në përmbushjen e premtimeve janë infrastruktura,

shërbimet publike, bujqësia dhe politikat sociale. Kështu, nga të gjitha premtimet e dhëna, në fushën e infrastrukturës janë dhënë 339 premtime ku deri në gjysmën e mandatit në këtë fushë janë përmbushur 129 premtime, në fushën e shërbimeve publike janë dhënë 104 premtime, ndërsa janë përmbushur 45 premtime, në fushën e bujqësisë në tërësi janë dhënë 46 premtime, prej të cilave 27 janë përmbushur, ndërsa në fushën e politikave sociale janë dhënë 31 premtime dhe janë përmbushur gjithsej 22 prej tyre", ka njoftuar GAP-i. Sipas GAP-it, fushat ku ka ngecje në përmbushjen e premtimeve janë arsimit, zhvillimi ekonomik,

shëndetësia dhe kultura. "Në fushën e arsimit janë dhënë 126 premtime, kurse janë përmbushur vetëm 22, në fushën e ekonomisë kemi evidentuar 71 premtime, ndërsa rezultojnë të përmbushura vetëm 13, në fushën e shëndetësisë janë dhënë 64 premtime, ndërsa janë përmbushur vetëm 12, kurse për kulturë janë dhënë 54 premtime e janë përmbushur vetëm 9", është thënë në këtë njoftim.

Instituti GAP ka theksuar se është duke bërë monitorimin e përmbushjes së premtimeve në 26 komuna, pasi disa nga kryetarët aktualë nuk kanë zhvilluar fushatë zgjedhore. "Komunat si Skenderaj, Mamusha dhe dhjetë komunat e



banuara me popullatë shumicë serbe nuk kanë shpallur ndonjë program zgjedhor dhe nuk kanë dhënë premtime konkrete gjatë zgjedhjeve të fundit lokale. Përmes vlerësimit të premtimeve zgjedhore, Instituti GAP ka për

qëllim që t'i mbajë të përgjegjshëm kryetarët e zgjedhur për premtimet e dhëna. Vlerësimi i premtimeve bëhet në mënyrë periodike përmes bashkëpunimit me organizatat lokale", ka njoftuar GAP-i.

## Deçani përkujton komandantin e UÇK-së, Halim Tolaj

DEÇAN, 23 SHKURT (ER) - Komuna e Deçanit, në bashkëpunim me Degën e Organizatës së Veteranëve të UÇK-së në këtë komunë, kanë përkujtuar të dielën komandantin Halim Dervish Tolaj në njëvjetorin e vdekjes. Në ceremoninë përkujtimore kanë marrë pjesë kryetari i Deçanit, Bashkim Ramosaj, deputetët e Kuvendit të Kosovës, Daut Haradinaj, Rasim Selmanaj, Teuta Haxhiu, Gazmend Sylja e Arbër Tolaj, kryetari i OVL-UÇK-së së

Dukagjinit, Avdyll Mushkolaj, familjarë të Tolajt dhe qytetarë. Me këtë rast, është thënë se Halim Tolaj nga Prejlepi i Deçanit tërë jetën ka qëndruar i palëkundur në idenë shqiptare dhe i palodhshëm në veprim për lirinë e atdheut. Në përvjetorin e parë të ndarjes nga jeta është bërë zbulimi i pllakës së varrit në Kompleksin e Varrezave të Dëshmorëve të Kombit në fshatin Prejlep. Aty komandant Tolaj pushon përjetësisht pranë shokëve bashkëluftëtarë.



## Shkollat e Dragashit, pjesë e programit 'Shkollat e shekullit 21'

DRAGASH, 23 SHKURT (ER) - "Shkollat e shekullit 21" është program arsimi ambicioz trevjeçar, i dizajnuar dhe zbatuar nga "British Council" dhe i financuar nga Qeveria e Britanisë së Madhe. I realizuar në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit në Dragash, ky program synon të pajisë me aftësi të mendimit kritik dhe zgjidhjes së problemeve 1 982 nxënës të moshës 10-15 vjeç, fillimisht për 5 shkolla në Komunën e Dragashit.



Përveç mësimit të aftësive të mendimit kritik dhe zgjidhjes së problemeve, fëmijët do të mësojnë aftësi praktike të programimit dhe do të kenë mundësi t'i praktikojnë aftësitë e tyre përmes informatikës

fizike. "Si pjesë e programit, shkollave do t'u sigurohen 1 50 pajisje 'microbit'-i, kompjuterë me përmasa që mbahen në xhep, të cilët fëmijët mund t'i programojnë dhe t'i përdorin në lëndë të ndryshme për t'i zgjidhur problemet e përditshme. Për të konkurruar në tregun global të punës, aftësitë si zgjidhja e problemeve, mendimi kritik, njohuritë digjitale dhe krijimtaria janë çelësi i suksesit", ka njoftuar Komuna e Dragashit.

## Nënshkruhet kontrata mbi 700 mijë euro për vazhdimin e punimeve në studimin e Kaçanikut

KAÇANIK, 23 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, ka nënshkruar kontratën për vazhdimin e punimeve në stadiumin e qytetit. Sipas njoftimit të kësaj komune, vlera e

projektit është 770 743 20 euro, ndërsa është përkrahur financiarisht nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Në këtë projekt do të rregullohen tribunat e stadiumit në pjesën perëndimore.



# Qeveria e re e Kosovës duhet ta sqarojë politikën e vet ndaj Serbisë



**Nga Jakup KRASNIQI**

Zhvillimet e fundit në Kosovë, përfshirë edhe presionin nga jashtë, që ka të bëjë me raportet e saj politike me Serbinë, e shtron domosdoshmërinë për ta sqaruar një herë e mirë politikën e saj të veprimit ndaj politikave agresive të Serbisë në përgjithësi e këtyre të pas pavarësisë së Kosovës, me theks të veçantë pas bisedimeve politike të Brukselit është bërë e domosdoshme. Gjithashtu, është bërë tepër e nevojshme një komunikim i ri me vendet euroatlantike me të cilat kemi ardhur deri këtu e të cilave vende duhet t'u themi se Kosova gjatë gjithë periudhës se pas qershorit 1999 ka bërë krejt çka ka qenë në mundësitë e saj për t'i normalizuar marrëdhëniet me Serbinë dhe i kemi bërë së bashku me ta. Për këtë qëllim kemi bërë shumë compromise të cilat i dimë dhe më i njohuri prej tyre është Dokumenti Gjithëpërfshirës për Zgjedhjen e Statusit Përfundimtar të

Kosovës, i njohur edhe si Dokumenti i Presidentit Ahtisari. Me atë Dokument, komuniteteve pakicë, e sidomos komunitetit serb, i janë ofruar të drejta të një standardi të lartë politik, sa edhe kanë rrezikuar funksionimin normal të institucioneve kushtetuese të vendit. Këto politika janë arritur së bashku me Grupin e Kontaktit, e veçmas me vendet euroatlantike. Ndërsa gjatë gjithë këtyre viteve, politika serbe nuk ka lëvizur nga llogoret e saj të luftës së njohur anti Kosovë e anti shqiptare. Pra, Serbia në asnjë moment nuk ka treguar vullnet për t'u shkëputur nga politikat e kriminit e të gjenocidit dhe filluar epokën e normalizimit të marrëdhënieve me Kosovën e qytetarët e saj. Kjo politikë u është mirë e njohur vendeve të demokracisë perëndimore dhe jo vetëm atyre.

Këtyre vendeve të botës euroatlantike e veçmas vendeve të BE-së që janë bërë pengesë e ecjes së Kosovës në rrugën e integriteteve veriatlantike, të cilave duhet treguar me argumente të gjitha arsyet pse Qeveria e Kosovës e ka vendosur taksën 100 % ndaj mallrave serbe e boshnjake. Nëse është nevojë për këtë çështje, le të formohet një trupë e përbashkët e vendeve euroatlantike për të ardhur pas një hulumtimi të një

përfundim i argumentuar se vërtet ku janë pengesat që pamundësojnë normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës e Serbisë?! Në Kosovë apo në Serbi, natyrisht duke u konsultuar me kujtesën administrative të Rambujesë e të Vjenës. Përndryshe çdo ngutje për të arritur çfarëdo përfundimi nuk do të jetë gjë tjetër vetëm se "një përpjekje sizifi", për t'u rikthyer sërish nga fillimi. Kjo situatë e kërkon domosdonë që t'i kthehemi kujtesës së arkivuar historike që nga bisedimet e Rambujesë, të Vjenës e krejt deri me sot. Për të hulumtuar atë kujtesë është mirë që nuk u duhet ndihma e Kosovës dhe as ajo e Serbisë. Përndryshe, çdo përpjekje për ta hequr taksën 100 % pa ndonjë qartësim se nga dëshirojmë të shkojmë e ku synojmë të arrijmë, nuk do të jetë një zgjidhje e frytshme e as e qëndrueshme, përkundrazi do të këtë dhe do të krijojë vështirësi të reja. Shkurt, duhet të përcaktohet qartë e saktë çka po dëshirojmë të arrijmë? Zgjidhje të problemit apo vazhdim të rrugës që e dimë dhe e dimë mirë që të gjithë që së bashku e bëmë këtë rrugëtim më shumë sesa njëzetvjeçar!

Po e zëmë se taksën edhe mund ta heqë Qeveria e re e Kosovës, po çka do të arrijmë me këtë veprim? Ndryshim substancial

apo vazhdim të avazit?! Dikush po thotë: ta heqim taksën e ta vendosim reciprocitetin?! Mirëpo, duhet sqaruar se për çfarë reciprociteti po flasim? A e di ndokush këtë? Nëse nuk e bëjmë një reciprocitet të plotë për çështjet më kardinale që e ndihmojnë normalizimin e raporteve Kosovë - Serbi, ndoshta është më mirë të mbesim këtu ku jemi e të presim ditë më të mira. Si kompensim për heqjen e Taksës së Qeverisë së Kosovës, cili do të jetë veprimi i Serbisë? A është ajo e gatshme për t'i normalizuar marrëdhëniet me Kosovën? Apo do t'ia lëmë Serbisë "Livadhisen në Livadhin e Babës"? A pak livadhisi ajo në livadhin e huaj?! Dihet që më shumë se njëqind vjet e tehu, Serbia e Jugosllavia nuk patën vesh në asnjë kohë e në asnjë rast që ta dëgjonin zërin e shqiptarëve për liri, barazi e demokraci. Përkundrazi, Serbia e donte Kosovën pa shqiptarët vendës, prandaj shumë herë ushtroi politika të kriminit të gjenocidit. Mosdënim i këtyre politikave të gjenocidit nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (pas tri luftërave të fundit) e kanë trimëruar shumë edhe Serbinë e sotme.

Në Kosovë ende ka shumë njerëz që e dinë se si kemi ardhur deri këtu ku jemi. E dimë se cila frymë politike, njerëzore

e kombëtare na solli këtu ku jemi, e cila frymë politike, njerëzore e qyqare ishte si uji i moçalit, i cili as nuk ecën e as nuk pihet. Dihet se me frymën e moçalit do të jetonim në moçalishten e Jugosllavisë së vogël (Serbi - Mal i Zi) ose të degdisur e të shpërndarë në botë si zogjtë e qyqes?! Ne të frymës së parë si dhe ata të frymës së dytë, e dimë se cila frymë e solli lirinë, çlirimin dhe pavarësinë e sovranitetin e vendit. Prandaj qeveritarët e vitit 2020 e kanë për obligim që qytetarëve të Kosovës t'u tregojnë se cilën frymë do ta ndjekin, rrugën e ndryshimit apo të moçalit?! Ndërsa qytetarët e dinë, kuptohet ata që kanë kujtesë kombëtare, jo ata që kanë kujtesë mize, se një pjesë e qeveritarëve të sotëm kanë pas ofruar një frymë më të avancuar se ajo që i ka sjellë ndryshimet që i kemi pas qershorit 1999, përfshirë edhe pavarësinë e shpallur më 17 shkurt 2008.

Ne, qytetarët e lirisë e të pavarësisë, duhet ta dimë saktë se nga cila frymë do të qeverisemi tani e tutje?! Do të qeverisemi nga fryma e parë, nga ajo e moçalit apo nga fryma më e avancuar sesa e para (e pavarësisë)?! Fryma e bashkimit kombëtar do të na bënte më krenarë! Dhe nuk kemi asnjë arsyeje që ta kundërshtojmë.

## Vetëm reciprociteti mund ta zëvendësojë tarifën

Në të ardhshmen nuk do të ketë bisedime në mes të Prishtinës dhe Beogradit për çështje të brendshme të Kosovës, por do të zhvillohen negociata me parime, në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, për çështje ndërshtetërore. Vetëm parimi i reciprocitetit garanton barazi në mes të palëve dhe marrëveshje të qëndrueshme.



**Ismajl KURTESHI**

Të gjithë ata që angazhohen për heqjen e tarifës, me qëllim të hapjes së rrugës për negociatat e

ndërprera në vitin 2018 në mes të Prishtinës dhe Beogradit, pa zëvendësimin e saj me reciprocitetin gjithëpërfshirës, realisht po angazhohen për negociata në mes të pabarabartëve.

Një gjë e tillë nuk duhet të ndodhë sepse:

- Sa herë që negociohet në mes të palëve të pabarabarta, negociatat nuk mund të prodhojnë marrëveshje të drejta.  
- Sa herë që marrëveshjet nuk janë të drejta ato nuk mund të

jenë të qëndrueshme.

- Marrëveshjet e paqëndrueshme shkaktojnë mosmarrëveshje të reja, prandaj negociatat që do të rifillojnë duhet të jenë të prira nga parimet që garantojnë zgjidhje të drejta për palët negociuese.

Kërkesa për heqjen e tarifës, pa zëvendësimin e saj me reciprocitet, është e padrejtë, prandaj nga një kërkesë e tillë duhet të heqin dorë të gjithë ata që angazhohen për zgjidhje të drejtë e të përhershme.

Ideja se marrëveshja duhet të arrihet përmes një kompromisi është absurde. A nuk i mjafton Serbisë zgjatja e dorës së pajtimin pas gjithë tmerreve që kanë pësuar shqiptarët nga politika hegjemoniste serbe për një shekull dhe garantimit të drejtave të plota komunitetit serb që jeton në Kosovë.

Ideja se duhet të bëhet kompromis me pavarësinë e Kosovës çon drejt destabilitetit të rajonit dhe, si e tillë, është e rrezikshme.

Është e padrejtë që për marrëveshjen që po i ngutet Serbisë, vazhdimisht të kërkohen compromise nga Kosova, e cila edhe ashtu ka bërë compromise më shumë se që është dashur.

Detyrë e institucioneve të Kosovës është ruajtja e

marrëdhënieve të mira me miqtë tanë por, para së gjithash, institucionet kanë për detyrë mbrojtjen e interesave të Republikës së re të Kosovës, që erdhi si rezultat i sakrificave sublime të gjeneratave të tëra të shqiptarëve dhe përkrahjes së miqve ndërkombëtarë.

Bisedimet e palëve të pabarabarta dhe marrëveshjet e padrejta na kanë mësuar që në të ardhshmen të mos ketë bisedime në mes të Prishtinës dhe Beogradit për çështje të brendshme të Kosovës, por negociata me parime, në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, për çështje ndërshtetërore.

Vetëm parimi i reciprocitetit garanton barazi në mes të palëve dhe marrëveshje të qëndrueshme.

## Shkon në 120 numri i të infektuarve nga koronavirusi në Itali, izoloohen 11 komuna

PRISHTINË, 23 SHKURT - Kina ka raportuar rënie të numrit të viktimitave nga koronavirusi, por ky virus ka shënuar rritje në Korenë Jugore si dhe 10 raste të reja janë paraqitur në Iran.

Numri i të prekurve nga ky virus vazhdon të rritet në vende të tjera të botës, duke shënuar dhjetëra raste edhe në Itali, Libi e Iran.

Numri i rasteve të banorëve italianë që janë prekur nga koronavirusi ka arritur në 120 prej të shtunës kur u konfirmuan edhe dy viktimat e para.

Ky lajm është konfirmuar nga vetë autoritetet italiane, pasi koronavirusi është përhapur në 11 komuna të Italisë duke treguar se virusi vdekeprurës tashmë ka prekur

Italinë.

Shumica e rasteve janë përqendruar në rajonet veriore të Lombardisë (e cila ka 89 raste), Veneto, Emilia Romagna dhe Piemonte.

Mediat italiane kanë shkruar se janë 90 raste të konfirmuara janë në Lombardi, 25 në Veneto, dhe 2 në Emilia Romagna, 2 në Lazio (çifti kinez), dhe në Piemonte.



## Bernie Sanders shënon fitore të madhe në Nevada

Me fitoren të shtunën në Nevada kandidati demokrat Bernie Sanders ka forcuar pozitat e tij si kryesues i garës kundër presidentit Trump në zgjedhjet e nëntorit

WASHINGTON, 23 SHKURT - Bernie Sanders fitoi të shtunën zgjedhjet brenda partisë në garën për zyrtarizimin e kandidatit demokrat që do të garojë kundër presidentit Trump në zgjedhjet e nëntorit.

Me fitoren në Nevada Sanders ka forcuar pozitat e tij si kryesues i garës mes demokratëve. Këto zgjedhje pasojnë proceset e ngjashme të mbajtura në Ajova dhe Nju Hepsheer në fillim të këtij muaji. Në dallim nga këto dy të fundit, me një popullsi dërrmuese të bardhë, Nevada është një shtet etnikisht i larmishëm. Popullsia është afërsisht gjysmë e bardhë, ndërsa pjesa tjetër janë rreth 30 për qind hispanike, 10 për qind afro-amerikane dhe 10 për qind aziatike.

Pas senatorit Sanders u rendit ish-nënpresidenti Joe Biden, në

vend të tretë u rendit ish-kryetari i bashkisë së South Bendit, Pete Buttigieg dhe në vend të katërt senatorja Elizabeth Warren. Sipas sondazheve, kujdesi shëndetësor ishte një çështje thelbësore e fushatës në Nevada. Më shumë se 40 për qind e votuesve thanë se kjo ishte çështja më e rëndësishme për ta në zgjedhjen e një kandidati, ndjekur nga rreth një e katërta, të cilët përmenden ndryshimin e klimës si shqetësimin e tyre më të madh.

Bernie Sanders ka dënuar përpjekjet e raportuara të Rusisë për të ndihmuar në fushatën e tij zgjedhore, duke u thënë të qëndrojnë larg zgjedhjeve amerikane.

Sanders tha se disa zyrtarë amerikanë i kishin thënë muajin e kaluar për përpjekjet e Rusisë që të ofrojnë ndihmë në fushatën e tij.



Gjatë një fjalimi në Bakersfield të Kalifornisë, Sanders tha se nuk është e qartë mënyra se si Rusia ka dashur të ndërhyjë në zgjedhje, por theksoi se ka refuzuar fuqishëm çdo përpjekje për ndërhyrje. Ai ka akuzuar presidentin rus, Vladimir Putin, për autokraci dhe përpjekje për të sjellë përçarje në ShBA. Sanders konsiderohet garuesi

kryesor nga ana e demokratëve për zgjedhjet presidenciale në ShBA.

Ndërkaq, presidenti Trump, gjatë fushatës në Nevada, tha se ndërhyrja ruse është propagandë e nisur nga demokratët.

Më 2016, inteligjenca amerikane kishte raportuar se Rusia ka përdorur një strategji të sulmeve kibernetike përmes lajmeve të

rrime kundër kandidatës demokrate, Hillary Clinton.

Një vit më vonë, ish-drejtori i Byrosë Federale të Hetimeve, u zgjodh këshilltar i posaçëm për të udhëhequr procesin e hetimeve ndaj Trump.

Më 2019, Mueller kishte dorëzuar një raport 448 faqesh përmes të cilit nuk është vërtetuar ndërhyrja ruse në zgjedhje.

## Krahu antiperëndimor fiton zgjedhjet në Iran

TEHERAN, 23 SHKURT - Rezultatet paraprake të zgjedhjeve parlamentare të së premtes në Iran tregojnë se konservatorët kanë fituar 70 për qind të 290 vendeve në parlament, ndjekur nga të pavarurit me rreth 20 për qind dhe reformistët me 10 për qind. Megjithatë, shumë vëzhgues kanë tërhequr vëmendjen për një pjesëmarrje jashtëzakonisht të ulët të votuesve në shumë

pjesë të vendit.

Pamje filmike amatore të transmetuara nga mediet arabe e iraniane tregonin disa persona jashtë qendrave të votimit në Iran tek shpreheshin se zyrtarët zgjedhorë kishin vjedhur zgjedhjet parlamentare të së premtes. Gjithashtu, pati disa njoftime në mediet sociale se pjesëmarrja ishte aq e ulët, sa zyrtarët iraniane vendosën që të mos i

shpallin përqindjen e saktë të pjesëmarrjes për çdo rajon, por në total për të gjithë vendin.

Me gjithë pjesëmarrjen në dukje të ulët, media iraniane shfaqti pamje filmike të presidentit Hassan Rouhani duke pohuar se zgjedhjet e së premtes ishin "një ngjarje e lavdishme në historinë e vendit dhe të revolucionit Islamik".

Ai shtoi se vendvotimet në të

gjithë vendin ishin të lidhura në internet dhe se ai ishte i mahnitur me punën e zyrtarëve zgjedhore.

Por fotot që qarkullonin në mediet sociale, tregonin zyrtarët zgjedhorë në një numër vendvotimesh tek zbraznin kutitë e votimit në dysheme dhe i numëronin ato me dorë.

Ish-presidenti iranian Abolhasan Bani Sadr i tha "Zërit të

Amerikës" se sipas raporteve që ai kishte është parë, më shumë se 80 për qind e iranianëve i kishin bojkotuar zgjedhjet dhe se qeveria nuk priste një reagim kaq të fortë nga publiku.

Ndërkohë zgjedhjet parlamentare të Iranit duket se përkojnë me një rritje të frikës në publik për shkak të shpërthimit të koronavirus në disa qytete të vendit.

## Nëntë të vdekur në Turqi si pasojë e tërmetit afër kufirit me Iranin

ANKARA, 23 SHKURT - Nëntë persona kanë humbur jetën dhe qindra ndërtesa janë shkatërruar nga tërmeti me magnitudë 5.7 që goditi juglindjen e Turqisë, afër kufirit me Iranin. Tre nga viktimat ishin fëmijë ndërsa nëntë të tjerë janë në

gjendje kritike, deklaruan nga Ministria e Shëndetësisë.

Tërmeti ka shkatërruar ndërtesat në qytetin Van të Turqisë si dhe në lindje në disa fshatra të Iranit, ku sipas raportimeve 75 persona mbetën të lënduar. Irani dhe Turqia janë vendet

më të prekura nga tërmetet në botë.

Një tërmet muajin e kaluar në lindje të Turqisë la të vdekur më shumë se 40 persona, ndërsa një tjetër në Iran shkaktoi dëme materiale, por pa fatalitete.



# SIGMA

## VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. DEGA KOSOVË

### NJOFTIM PËR ZHVENDOSJE TË ZYRËS

*Të nderuar klientë dhe palë të interesuara,*  
Ju njoftojmë se Zyra Qendrore e kompanisë së sigurimeve Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A. Dega Kosovë do të zhvendoset në adresën e re, që është:  
• **Aktash, Rr. Edmond Hoxha nr. 27 (afër udhëkryqit tek menza e studentëve), Prishtinë 10000, Republika e Kosovës**

Data e planifikuar/propozuar dhe për zhvendosjen e zyrës qendrore është 23.12.2019.  
Ne do të vazhdojmë të jemi në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar shërbimet e kompanisë tonë të sigurimeve në adresën e re të lartshënuar të Zyrës Qendrore.  
**Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe ju**

### mirëpresim në zyrat e reja! NOTICE FOR OFFICE TRANSFER

*Dear clients and interested parties,*  
We inform you that the Head Office of insurance company Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A. Kosovo Branch will move to the new address, that is:  
• **Aktash, Edmond Hoxha Str. No. 27 (near the crossroads of the student mess canteen), Prishtina 10000, Republic of Kosova**


The planned/proposed date for the Head Office transfer is 23.12.2019.  
We will continue to be at your disposal to offer our insurance company's services at the above new Head Office address.

Thank you for your understanding and welcome to the new offices!

### OBAVIJEST O ZAMJENI KANCELARIJE

*Dragi klijenti i zainteresovane strane,*  
Obaveštavamo vas da će glavno sedište osiguravajucceg društva Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A. Filijala Kosova preseliti na novu adresu, a to je:  
• **Aktash, Ul. Edmond Hoxha br. 27 (blizu raskrsnice studentske menze), Priština 10000, Republika Kosova**

Planirani/predložni datum preseljenja kancelarije na novu adresu glavnog sedišta je 23.12.2019.  
Me čemo i dalje biti na vašem raspolaganju da vam pružimo usluge našeg osiguravajucceg društva na gore navedenu novu adresu glavne



**SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. - DEGA KOSOVË**

Qyteza Pejton, Rr. Ukshin Hoti Nr.13, Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel.+381 38 246 301, Fax. +381 38 246 302 [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net) [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net)



LENORE KANDEL

# KUR NJË SHOQËRI FILLON TË KETË FRIKË NGA POETËT E VET, KJO DO TË THOTË SE KA FRIKË NGA VETJA

Poezia nuk komprometohet kurrë. Është manifestimi - përkthim i një vizioni, një ndriçim, një përvojë. Nëse bëni kompromis, bëheni një profet i verbër.

Nuk ka kuptim sot në atë poezi që ekziston vetëm si një detyrë e ushtrimit. Teknika është e nevojshme për aq kohë sa shërben si një mami e aftë për qartësi, bukuri, vizion.

Kur dashurohet me veten, ajo prodhon masturbim verbal. Poezitë që unë shkruaj kanë të bëjnë me të gjitha aspektet e krijesës dhe të atij universi total përmes të cilit lëviz. Qëllimi është të rritet ndërgjegjësimi. Kjo mund të jetë vetëdije për mënyrën se si një zog shpërthen qiellin me fluturimin e tij ose vetëdijen për vështirësinë dhe nevojën për besim ose vetëdije për dëshirën për vetëdijen, madje edhe për frikën e vetëdijes. Dhe kjo mund të arrihet përmes bukurisë ose tronditjes ose të qeshurës, por drejtimi është gjithnjë drejt një pamje të qartë, të brendshme dhe të jashtme.

Kjo kërkon ndershmëri brenda poetit dhe poezisë. Një i sinqertë, nganjëherë i gëzuar, ndonjëherë i dhimbshëm, drejtuar vetë poetit ose lexuesit ose të dyve. Dy nga poezitë e mia, të botuara në një libër të vogël, kanë të bëjnë me dashurinë fizike dhe thirrjen, njohjen dhe pranimin e hyjnisë të njeriu përmes mediumit të dashurisë fizike. Me fjalë të tjera,

është kënaqësi. Një kënaqësi kaq e madhe sa ju bën të aftë të dilni nga vetja juaj private dhe të merrni pjesë në hirin e universit. Ky formulim i thjeshtë dhe mjaft i dukshëm, i zgjeruar dhe i ilustruar poetikisht, ka ngritur një tërbim të vështirë për t'u besuar. Pjesa më e madhe e këtij tërbimi ishte për shkak të përdorimit poetik të fjalëve të caktuara të katër shkronjave me origjinë anglosaksone, të cilat nuk u zëvendësuan me gufemizma më delikate.

Nga këtu arrijmë te pyetja e gjuhës poetike.

E gjithë ajo që është gjuhë, është gjuhë poetike dhe nëse fjala e kërkuar nga poeti nuk ekziston në gjuhën e njohur për të, atëherë i takon atij ta zbulojë. Kushti i vetëm kufizues mund të jetë që fjala është e sakta që kërkohet nga poezia dhe vetëm poeti mund të jetë gjykatësi i fundit i saj. Eufemizmat e zgjedhur nga frika janë një pakt me hipokrizinë dhe në afatin e menjëhershëm ata do ta shkatërrojnë poezinë dhe përfundimisht dhe do ta shkatërrojnë poetin.

Çdo formë e censurës, mendore, morale, emocionale ose fizike, qoftë nga brenda apo nga jashtë, është një pengesë kundër vetëdijes. Poezia është e gjallë sepse është një medium vizioni dhe përvojë. Nuk është domosdoshmërisht e këndshme. Nuk është domosdoshmërisht e

padëmshme.

Poezia doli nga një klasë e shkollës, pastaj shkoi në rrugë dhe kështu prodhoi një rrjedhë të palmave të kryqëzuara, të cilat dhanë shumë fruta jetike si për poezinë ashtu edhe për shkollën. Bota akademike donte të gjeneronte frikën në shkeljen e kodit, duke ofenduar dikë. Vizionet dhe gjuha shpesh bëheshin më të vogla, të mbytura nga një shurdhëri. Një poezi pastaj bëhej shpeshherë mjet për gjimnastikën letrare.

Poezia e rrugës shmang kurthin e frikës, por shumë shpesh ajo humb vizionet e veta për mungesë qartësie, për ngurtësi, për mungesë arti si profesion. Poezia që është poezi nuk ka nevojë të klasifikohet sipas dy kutive të përshkruara më lart e as në ndonjë mënyrë tjetër. Nuk mund të ekzistojë në shoqërinë e censurës. Nëse një poet censuron vizionin e tij ai nuk thotë më të vërtetën kur e sheh atë. Nëse censuron gjuhën në një poezi, ai nuk përdor ato fjalë që për të janë fjalët më të përsosura që ai duhet t'i përdorë. Ky vetëplanifikim krijon një kufizim artificial të imponuar ndaj një arti, drejtimi i të cilit është përtej kufijve të mundshëm. Nuk ka pengesa për poezinë apo profecinë. Për nga natyra e tyre ato shkelin çdo pengesë, ato janë qëllime perceptimi, linja drejt pafundësisë. Nëse një poet

gënjën mbi vizionin e tij, ai gënjën mbi veten dhe për veten e tij dhe kjo prodhon një pengesë të vërtetë. Kur një poet, për oportunitizëm, diktuar nga frika, përdor një gjuhë të ndryshme nga ajo që është e përsosur për një poezi, ai bëhet person me oportunitizëm të frikshëm. Kur një agent i jashtëm merr përsipër detyrën e censurimit të poezisë, kjo nënkupton censurimin e pranimit të së vërtetës dhe kërcimin drejt zbulimit.

Kur një shoqëri fillon të ketë frikë nga poetët e vet, kjo do të thotë se ka frikë nga vetja. Një shoqëri që ka frikë nga vetvetja është një mënyrë tjetër për ta përcaktuar ferrin. Një poezi pasi është shkruar dhe botuar është në dispozicion për ata që vendosin ta lexojnë atë. Sipas mendimit tim, kjo nënkupton një përgjegjësi të thellë nga ana e poetit, i cili thotë të vërtetën ashtu siç ai e sheh. Lëreni ta thotë me gjithë bukurinë, aftësinë për të befasuar, për të cilën është i zoti; të shkaktojë ndjenjën e tij për çudi; të përdorë alkimi brenda gjuhës - këto janë forma dhe ekzistenca e vet poezisë.

Publiku i poezisë moderne është kryesisht i ri. Të lëvizim në një botë ku polaritetet dhe mundësitë e jetës dhe vdekjes ekzistojnë si një prani e vazhdueshme e vetëdijes. Pasi koncepti dhe fizibiliteti i mbingarkesës, madje edhe i potencialit të tepërt

shkatërrues, është bërë i njohur për të gjithë, aura e mundësisë së një vdekjeje kozmike është bërë e dukshme. Ishin epokat kur të rinjtë mund të rrëshqitnin butësisht në jetën e tyre si pleq e, nëse donin t'i injoronin problemet më të thella të njerëzimit, të marrëdhënies së njeriut me njeriun, kjo u lehtësohej atyre. Epoka jonë sigurisht që nuk është një nga ato dhe zgjedhjet e të rinjve janë të thella dhe të vështira. Nën tetëmbëdhjetë vjeç djemtë duhet të vendosin nëse do t'i përkushtohen kalimit kombëtar të vdekjes. Shumë nga ata, në vend se ta pranojnë botën e luftës dhe dëshpërimin personal që u propozohet atyre nga shumica e të pjekurve, zgjedhin të manifestojnë një mënyrë të ndryshme të jetës, të motivuar drejt kënaqësisë, drejt ndriçimit dhe vëmendjes së ndërsjellë.

Këto janë zgjedhje të vështira për t'u bërë, të cilat nuk lejojnë ikje. Ata që lexojnë poezinë moderne e bëjnë për kënaqësi, për ta njohur më thellë, ndonjëherë edhe për të gjetur këshilla. Dhe më së paku që mund të presin është se poeti që ndan vizionet dhe përvojat e tij me ta, e bën këtë pa hipokrizi. Bërja e kompromiseve në poezi nga frika nënkupton atrofizimin e psikikës. Kompromisi për oportunitizëm në poezi është kapësja\* e vogël vrasëse e shpirtit.

*Përktheu: Leonora Buçinca*

# PËRJETËSIMI LETRAR



VIOLETA ALLMUÇA

Krijuesi, qysh kur ka filluar të shkruajë një libër, ka zbuluar brenda botës së madhe edhe një botë tjetër, që quhet bota e tij e artit për ta publikuar në botën njerëzore. Mendimit për të sjellë një vepër artistike, poezi apo roman, me synimin e rrëfi-mit të vetes, hapësirës dhe kohës së jetës së krijuesit, i përgjigjen sistematikisht disa pyetje të vështira. A e ka zhvilluar ky libër majën e thurjes së mendimit e vlerësimit? A e ka ky libër rrjedhën e vështimit dhe studimit kritik? A janë disa rezultate në pajtim ose mospajtim me shkrimin e një libri që lidhen si një tërësi rezultatesh apo një vizion dhe fantazi e shkrimtarit? Çfarë ndodh me rivlerësimin e të tjerëve, për atë që i paraqet lexuesit? Letërsia e mirëfilltë, si gjithmonë për të qenë objekt i mendimit artistik, duhet pranuar që duke pasur koherencën letrare, t'i shpallë lidhjet pa komplekse të dialektikës mes krijimit dhe mendimit. Po ashtu, koncepti i interpretimit dhe shqyrtimit duhet kuptuar si një veprim letrar dhe ndërveprim studiuesish. Veçantitë e shkrimit të një libri mbështeten në çështjet e tërësore dhe shpirtërores, ku dëshmohet veprimi i fushës së ekzistimit të një vepre po aq letrare, sa edhe mendimi për realizimin e sistemit analitik dhe estetik. Tërësia e strukturës së një vepre letrare mund të kuptohet nëse lënda e krijimit përmbush kuptimin e drejtë të shkrimit. Në fund të fundit pyesim: A e pranojnë shkrimtarët se kanë nisur të bëjnë një vepër letrare me një kombinim të përbashkët krijues dhe studiues? A duhet të bashkohet dokumenti i krijuesit me veprimin hulumtues dhe kritik? Studimet e mëtejshme në kohët e sotme, ndërsa e ngritin lart funksionin e krijimit artistik, i kujtojnë autorit të mos harrojë edhe funksionin estetik apo mendimin letrar, në radhë të parë, të lexuesit që strukturën e asaj çka lexojnë duan ta ndiejnë në tërësinë e tyre shpirtërore. Letërsia e Rilindjes Kombëtare jo vetëm që shkruhej shqip me idenë e çlirimit kombëtar, jo

vetëm i mëshonte bashkimit kombëtar, por ajo pati jehonë në epokën e saj, megjithëse momenti artistik, veçanërisht në poezi, nuk ishte dominues. Formësimi si art letrar shfaqet pas viteve '30, ndërsa pas vitit '45 arti dhe krijimi u kthyen në përkrahës të ideve ideologjike gjatë rendit shoqëror të kohës, ku spikati edhe letërsia, e disidentëve të regjimit, si Kasem Trebeshina, Visar Zhiti, Bujar Xhaferri etj., veprat e të cilëve morën edhe vëmendjen e kritikës dhe studimeve letrare që i quajti edhe "disidentë" estetikë. Botëkuptimi mbi artin dhe letërsinë pas viteve '90 nxiti prodhimin artistik dhe mori hov, përkundër heroizmit të lirisë, ndërsa ra në sy numri i madh i krijuesve në shoqërinë shqiptare të kohës. Ndryshimi i dukshëm i strukturës krijuese me ndërrimin e mendimit, reflektimit mendor dhe shpirtëror, kërkoi të ishte i qenësishëm në tërësinë krijuese dhe pak e pohuar në sferën e mendimit kritik. Sot kemi një tip tjetër krijuesi që sjell një formë të re, një stil të ri, që kemi pasur privilegj ta konstatojmë si një përvojë të re. Sot gjithçka letrare ose joletrare lejohet, mu siç edhe pritej, sepse edhe liria ishte qëllim në vetvete. Jetët dhe fatet njerëzore në mënyrë të vetëdijshme po sjellin sot edhe krijuesit e socrealizmit në veprat letrare si përsëritje të rrëfimit në kuptimin e kohës së re. Po ashtu, edhe krijuesit e pas viteve '90 kanë rritur sasinë e botimeve, duke pasur si kuptim vetëm iluzionin e të qenit vepër letrare, sipas frymës estetike. Mendimi kritik çuditërisht ende mungon. Tipi i krijuesit të sotëm që ka thyer zinxhirët e së shkuarës në diktaturën komuniste, i cili synon shpalimin estetik nëpërmjet gjuhës artistike, vijon ta rikrijojë lëndën e tij, jashtë konceptit dhe përvojës që ka ekzistuar, në zbulimin e heroit dialektik dhe ligjeve të mohimit të "heroit" të shkuar, si "antiheroit" i sotëm. Por, ashtu si jeta njerëzore shkon në vazhdimësi, edhe fjala artistike ndjek rrugën e vet. Shkrimtari i sotëm e vendos prototipin letrar si një objekt mohues, dobia e të

cilit, meqë nuk ka përligjur lirinë, e kthen në tendencë jashtëkohore. Letërsisë që i thyhen prangat shpirtërore me ndërgjegjen e lirisë e bën dukshëm të arsyeshëm ndjeshmërinë e krijuesit që lëshohet vullshëm sipas përvojës së tij morale, estetike dhe artistike. Tipari i krijuesit të sotëm, meqenëse në art duhet të mbizotërojë estetika, e ka kthyer interpretimin e veprës letrare në rrafshin e "vetëreklamës" duke e menduar librin si një "kryevepër" të tij, pa mendimin kritik dhe studimor, nëse ajo është dhe do të mbetet një vepër letrare e vërtetë.

Veprat e Naim Frashërit, Jeronim de Radës, Ndre Mjedës, Asdrenit etj., me theks romantik gjithëherë përmes poezisë, sollën libra me tematikë kombëtare dhe identitet kombëtar. Ndaj veprat e tyre, përvoja krijuese, hulumtimi i gjatë, përfshirë edhe mendimin kritik të mëvonshëm, siç bëri Konica edhe si kritik letrar, Fishta, Çajupi, Fan Noli etj., tërhoqën vëmendjen e lexuesit. Lasgush Poradeci vjen me poezinë lirike moderne shqiptare duke vlerësuar edhe anën estetike të veprës letrare. Ai ka arritur në nivelin e vetëdijes deri te lexuesit e sotëm, edhe pse nuk shkroi me metodën e realizmit socialist. Veprat e shkrimtarëve të Rilindjes Kombëtare (1836-1912) mbeten edhe pas 183 vjetësh gjithnjë të lexueshme deri në ditët e sotme, pasi duket se e kanë arritur përjetësimin letrar.

Letërsia pas vitit '45, për afër gjysmë shekulli si pasqyruese e një kohe letrare, ishte në shërbim të ideologjisë së realizmit socialist. Me misionin e artit "popullor", me parimin e letërsisë së partisë, në aspektin bashkëkohës, krijuesin intelektual apo të "klasës" punëtore e shtynte në dhënie e një interpretimi anësor që i shërbente dhe ishte i përshtatshëm për regji-min. Veprat e Dhimitër Shuteriqit, Ismail Kadaresë, Dritëro Agollit e të tjerëve, edhe pse kishin afër kritikën e kohës, si reflektim që e plotësonte këtë mision, kjo letërsi nën totalitarizëm nuk do të ishte e lirë. Lënda shpirtërore dhe liria e krijuesit ishin "vdekjeprurëse" në aspektin e krijimit dhe interpretimit të veprës ashtu siç u rrënuar edhe fjala hyjnore. Ndaj kjo letërsi, me përjashtim të pak krijuesve, nuk arriti të shfaqet si letërsi përjetësuese. Kujtojmë këtu se vepra e Kadaresë u ekuilibruar pas suksesit universal edhe në letërsinë shqipe. Dritëro Agolli mbeti shkrimtari më origjinal që iu qas lexuesit popullor me veprën e tij. Çështja e atëhershme mbetej të mos përulej sistemi. Jo të gjithë shkrimtarët ndoqën metodën e socrealizmit siç ishin: Jakov Xoxa, Frederik Rreshpja, Zija

Çela e të tjerë, të cilët sollën vepra me elemente realistë e ndjeshmëri moderne në poezi e prozë. Kritika letrare e kohës e shënjoji këtë moment si një përshkallëzim vlerash në krijimtarinë me frymën e kohës. Regjimi me misionin e tij mundi ta gjymtonte lirinë e çdo krijuesi që nuk i shërbente historisë së monizmit. Megjithatë letërsia e realizmit socialist me prurjet në poezi e prozë duhet studiuar me vëmendje për vlerat dhe antivlerat letrare, dhe jo vlerat ideologjike. Vlera përbëjnë ato vepra që lexohen edhe sot, që do të lexohen nesër dhe në të ardhmen si një letërsi e mirëfilltë.

Pluralizmi i ideve pas viteve '90 krijoi një letërsi ku dominoi përpjekja për ta sublimuar lirinë me vepra polivalente. Shkrimtarë të njohur si Fatos Kongoli, Luljeta Lleshanaku, Ervin Hatibi, Fate Velaj e të tjerë kanë sjellë vepra të reja ku frymon plotësisht liria e munguar, një letërsi moderne,

drejt një stili individual, ku shihen vlerat estetike, liria shpirtërore, një formë e re dhe një përvojë universale.

Sot botohen libra pafund. Për fat të keq, nga të ashtuquajturit "kritikë" shkruhet përgjithësisht për çdo vepër letrare, duke lënë në hije edhe ndonjë krijues të vërtetë. Shumë pseudoshkrimtarë e kanë kthyer fushën e letrave në një duel, ku veshjes artistike dhe lëndës letrare nuk i vishet mendimi kritik dhe estetik. Hulumtimi i faktorëve sa artistikë dhe estetikë, mendimi mbi veprën apo vlerën e një libri, mjeshtëria e shprehjes artistike e të tjera, kur letërsia merr vlerën e artit, vetëm studimet letrare dhe rrjedha kritike mbeten një argumentim përbërës që çon në përjetësinë e veprës letrare. Ndoshta do të duhet shumë kohë të evidentohen vlerat artistike dhe estetike të letërsisë së sotme që dallohet nga letërsia shqiptare e mëparshme.



GONÇALO M. TAVARES

## PROJEKTET

Pylli rritej shumë ngadalë, ndryshe nga çfarë kishte ndodhur, kur befas u shfaq një njeri dhe e prezantoi projektin e tij.

Tri ditë shkulën dru.

Ditën e katërt pushuan pas një pune të lodhshme.

Pas një viti erdhi njeriu i dytë, e pa hapësirën dhe tha: Këtu mungojnë drunjtë. Në tri ditët e ardhshme mbollën fidanë.

Ditën e katërt pushuan pas një pune të lodhshme.

Pas dymbëdhjetë vjetëve pylli sërish ishte i dendur.

Atëherë erdhi njeriu i tretë...

## NJERIU

Në një vend u shfaq një njeri me dy koka. Të gjithë e shihnin si bishë dhe jo si njeri.

Në një vend tjetër u shfaq një njeri që përherë ishte i lumtur. Të gjithë e shihnin si bishë dhe jo si njeri.

## KËNGËTARI

Zogu u godit në krahun e djathtë dhe, për këtë shkak, fluturonte në formë të diagonales.

Pak më vonë u godit në krahun e majtë, prandaj pushoi së fluturuar. Vetëm ecte për toke.

Pak më vonë një plumb e goditi në këmbën e majtë. E ai ecte në formë të diagonales.

Pas disa javësh një tjetër plumb e goditi në këmbën e djathtë, prandaj zogu as nuk mund të ecte.

Nga ai çast iu përkushtua vetëm këngës.

*Përktheu: Salajdin Salihu*



# Pra, në të vërtetë, nuk qenka Gutenbergu ai që shpiku shtypshkronjën

M. Sophia NEWMAN

Nëse një libër do të cilësohej “i njohur botërisht si më i rëndësishmi nga të gjithë librat e shtypur”, cili prisni të jetë? Nëse do të ishit Margaret Leslie Davis, përgjigja do të ishte e qartë. Edhe libri i saj me titull “Gutenbergu i humbur: historia befafuese e Odisesë pesëqind vjeçare të një libri”, botuar në mars 2017, fillon pikërisht me këtë cilësor. Libri rrëfen sagën e kopjes së vetme të Biblës së Gutenbergut, njëri nga disa kopjet e mbijetuara të Biblës 450 vjeçare, shtypur nga Johan Gutenbergun (Johannes Gutenberg), shpikësi i hamendësuar i shtypshkronjës, një nga projektet e tij më të hershme, kopje të cilat rrugëtuan gjatë shekullit të 20-të pasi u shitën, u zotëruan nga koleksionistët, bibliotekat dhe arkivat.

Davis citon Mark Tuenin (Mark Twain), i cili në 1900 shkroi, një letër me rastin e hapjes së “Muzeut Gutenberg”. Për Davis-in, fjalët e Tuenit ishin “shumë me vend.” “Çfarë është bota sot,” shkroi Tuenin, “me të mirën dhe të

keqen, ia detyron Gutenbergut. Gjithçka e ka zanafillën tek ky burim...” Në të vërtetë, risia e Gutenbergut është parë për një kohë të gjatë si pikë kthese në historinë njerëzore, risi e cila shtroi rrugën për Reformën Protestante, Rilindjen, revolucionin shkencor, përhapjen në masë të arsimit, dhe mijëra ndryshime të tjera që prekin thujtë çdo gjë që njohim sot. Ky është i vetmi problem?

Pohimi i përbotshëm bërë më lart, në të vërtetë, nuk është edhe aq i përbotshëm, dhe Gutenbergu vetë është vetëm njëri nga burimet e shtypshkrimit dhe jo burimi i vetëm. E vërteta është se risitë themelore në atë që do të përbënte ndryshimin rrënjësor në teknologjinë e shtypshkrimit nisën në Azinë lindore, me punën e bërë nga fisnikët e dinastive kineze, budistët korean, dhe pasardhësit e Xhengis Khanit, dhe, kjo është një vërtetë të cilën Davis e pranon me fare pak fjalë, ndërkohë që puna e tyre filloi disa shekuj para se të lindte Gutenbergu.

Në një shtypshkronjë tradicionale, pllakëza të vogla metalike me

shkronja të krijuara në anën e prapme, të njohura si shkronja të lëvizshme, përshtateshin në një kallëp të mbuluar me bojë, i cili vendosej në një copë letre. Pas heqjes së letres, mbetej faqja e shtypur. Ky proces përsëritej aq herë sa faqe kishte libri, për të patur një libër të shtypur. Dhe nëse kjo përsëritej edhe me librin, libri shtypej shpejt dhe në shumë kopje.

\*\*\*

Shtypshkronja shpesh thuhet se është krijuar nga Gutenbergu në Mainz, Gjermani, rreth viti 1440 pas Krishtit, dhe filloi të zërë rrënjë në Evropë në vitin 1450 me shtypjen e Biblës së lartpërmendur. Vetë librat kishin qenë të pranishëm në Evropë shumë kohë më parë, natyrisht, por vetëm vëllimet e kopjuara me dorë, të cilat në pjesën më të madhe binin në duart e pjesëtarëve të klerit. Qasja ndaj librave të prodhuar në masë ndryshoi rrënjësisht në fund të viteve 1400, me përhapjen e shkrimit dhe leximit duke e ndryshuar fenë, politikën, dhe stilin e jetës

në të gjithë botën.

Së paku, kjo është historia që tregohet në shumicën e librave, duke përfshirë, në pjesën më të madhe të librit, “Gutenbergu i humbur”. Por një fjali e vetme nga fundi i librit tregon për një histori më të gjatë: “Shkronjat e lëvizshme ishin shpikje kineze e shekullit të 11-të, e çuar më tej në Korenë e vitit 1230, para se në Evropë të krijoheshin rrethanat në kohën e Gutenbergut që të lulëzonte shtypshkrimi”. Kjo fjali minimizon dhe paraqet në mënyrë të gabuar çfarë ka ndodhur.

Hapat e para të zhvillimit të shtypshkrimit filluan afërsisht 800 pas Krishtit, në Kinë, ku teknikat e hershme të shtypshkrimit përfshinin krijimin e një faqeje tekti të plotë në një kallëp druri, me bojë, duke shtypur faqet në kallëpin e drurit. Rreth vitit 971 pas Krishtit, në Zhejiang, Kinë, u prodhuan një makinë shtypi e standartit budist e quajtur “Tripitaka” me këto kallëpe druri të gdhendura, duke përdorur 130.000 kallëpe (një në secilën faqe). Përpjekjet e mëvonshme do të krijonin lloje të mëhershme

të shkronjave të lëvizshme duke përfshirë përdorimin e suksesshëm por të pamjaftueshëm të ideogrameve të gdhendura në dru dhe një përpjekje të shkurtër, të pafrytshme për të krijuar shkronja prej qeramike.

Ndërkohë, importet perandorake nga Kina i sollën këto risi për sundimtarët korean të quajtu Goryeo (emrin e të cilëve ka sot Korea), të cilët kishin rol vendimtar në hapat e mëpasme të historisë së shtypshkrimit. Pjesa e tyre e historisë ka shumë shembuj risish gjatë pushtimit. Së pari, në 1087 pas Krishtit, një grup nomadësh të quajtur Khitans u përpoqën të pushtonin gadishullin korean. Kjo bëri që qeveria Goryeo të krijojë Tripitakan e saj me shtypshkrim me kallëpe druri, ndoshta me qëllim ruajtjen e identitetit korean budist përballë pushtuesve. Përpjekja do të ishte largpamëse. Ajo ruajti konceptin dhe teknikën për vitet e mëvonshme, kur arritën shumë më shumë pushtues. Në shekullin e 12-të dhe 13-të, sundimtari Mongol, Xhengis Khan kishte krijuar perandorinë më të madhe në



historinë njerëzore, e cila shtrihet nga Bregu i Paqësorit në Azi, drejt perëndimit deri në Persi. Pasi vdiq në 1227, pasardhësi i tij, Ögedei Khani, vazhdoi duke pushtuar territore që nuk i kishte pushtuar Xhenghis Khani asnjëherë më parë. Në vitin 1231, Ögedei urdhëroi pushtimin e Koresë, dhe në 1232, trupat pushtuese mongole arritën në kryeqytet. Gjatë pushtimit, ata dogjën kopjen koreane të Tripitakas duke e bërë shkumb e hi.

Dinastia Goryeo e rikrijoi menjëherë librin. Mendohet që të ketë qenë libër me "Lutje fuqisë së Budës për mbrojtjen e kombit nga mongolët pushtues", siç shkruhet në një tekst të Thomas Christensen-it, por u bë edhe me qëllimin për ta ruajtur kulturën e dinastisë. Dhe kjo ishte e rëndësishme sepse sulmet nga mongolët do të vazhdonin edhe 28 vjet më pas. Me ribërjen e Tripitakas ishte menduar të merreshin murgjit korean të cilët duhet ta përfundonin deri në vitin 1251 pas Krishtit, ndërkohë që sundimtarët filluan të shtypin libra të tjerë. Në vitin 1234 pas Krishtit, ata i kërkuan pastorit civil të quajtur Choe Yun-ui të shtypte një libër budist me titull "Tekst këshillues i ritualeve për të kaluarën dhe të tashmen" (Sangjeong Gogyeum Yemun). Por ky libër i gjatë kërkonte një numër të madh kallëpesh druri, kështu që Choe propozoi një zgjidhje tjetër. Duke u mbështetur në përpjekjet e mëparshme kineze për të krijuar shkronja të lëvizshme, ai zbatoi një metodë që ishte përdorur gjatë prerjes së monedhave prej bronzi për të krijuar shkronja tri përmasore në metal. Pastaj këto pjesë i rregulloi në një kornizë, i mbuloi me bojë dhe i përdori për të shtypur fletë letre. Pas kësaj, ai mund të riorganizonte shkronjat metalike, duke hequr nevojën e nevojshme për kallëpe druri të gdhendura. Ishte proces deri diku më i shpejtë. Ai e përfundoi projektin në vitin 1250 pas Krishtit.

Është e rëndësishme ta pranojmë se çfarë do të thotë kjo. Risia që Gutenbergu thuhet se ka krijuar ishin kallëpe të vogla metalike me shkronja të ngjitura prapa, të rregulluara në një kornizë, të lyera me bojë dhe të shtypura në një copë letër, e cila lejonte që librat të shtypeshin më shpejt. Por Choe Yun-ui e bëri këtë para tij dhe ai e bëri 150 vjet para se të lindte Gutenbergu. Ndoshta duhet të jetë Choe Yun-ui, emri që duhet të mbajmë mend, jo ai i Gutenbergut.

Sidoqoftë, librat e shtypur të Koresë nuk u përhapën me shpejtësi, siç do të përhapeshin librat e Gutenbergut 200 vjet më vonë. Kjo ngaqë Koreja ishte e pushtuar, gjë që i pengoi ta përhapnin këtë risi të shpikur nga ata. Për më tepër, shkrimet koreane, të mbështetura më pas shumë tek kinezishtja, përdorën një numër të madh shkronjash të ndryshme, të cilat e bënin krijimin e pjesëve metalike dhe



**Gutenberg**

bashkimin e tyre në faqe, një proces të ngadaltë. Më e rëndësishmja, sundimtarët e Goryeo-synuan që pjesa më e madhe e projekteve të shtypjes së librave të përdorej vetëm nga fisnikëria. Megjithatë, ka mundësi që teknologjia e shtypjes së librave të jetë përhapur nga Lindja në Perëndim. Ögedei Khan, udhëheqësi mongol, kishte një djalë të quajtur Kublai i cili e kishte shpallur veten si sundimtar në Pekin. Kublai Khan kishte mundësi ta përdorte teknologjinë koreane dhe kineze të shtypjes së librave, dhe mund t'ia ketë përcjellur këtë njohuri nipit tjetër të Xhenghis Khanit, Hulegu-t, i cili në atë kohë sundonte pjesën perse të perandorisë mongole. Kjo mund ta ketë zhvendosur me mijëra milje teknologjinë e shtypjes së librit nga Azia Lindore në perëndim. "Mongolët thjesht prireshin ta merrnin teknologjinë e tyre kudo ku shkonin, dhe ajo bëhej pjesë e kulturës lokale, nganjëherë e pranuar, nganjëherë jo", shpjegon profesori historisë aziatike në universitet, Colgate David Robinson.

Për të kaluar nga Azia Lindore në Persi asokohe udhëtohej përmes Rrugës së Mëndafshit. Në mes të asaj rruge shtrihet atdheu i popullit ujgur, një grup etnik turk i rekrutuar në ushtrinë mongole shumë kohë më parë. "Nëse kishte ndonjë lidhje me përhapjen e shtypjes së librave midis Azisë dhe Perëndimit", shkroi studiuesi Tsien Tsuen-Hsien në librin "Shkenca dhe qytetërimi në Kinë në vitin 1985, "ujgurët që përdorën si shtypjen dhe shkronjat e lëvizshme kishin mundësi të mira për të luajtur një rol të rëndësishëm në këtë proces".

Kjo pasi, në shekullin e 13-të, ujgurët shiheshin si njerëz të dalluar, të kënduar, nga ata për të cilët shtypshkrimi mund të ishte një risi e mirëseardhur. Ata kishin gjithashtu diçka të cilën askush tjetër nuk e kishte pasur

deri atëherë: një alfabet, një grup i thjeshtë me deri diku pak shkronja për të shkruar çdo fjalë që dëshiroje të thoshe.

Në perandorinë perëndimore mongole nuk pati lulëzim të shtypshkrimit. "Nuk kishte treg, nuk kishte nevojë që udhëheqësit të komunikonin me nënshtetasit nëpërmjet librit, nuk kishte nevojë të mblidhej ose investohej kapital në një industri të re", thekson historiani John Man në librin e tij, "Revolucioni Gutenberg". Megjithatë, shtypshkronjat me shkronja të lëvizshme të ujgurëve, u zbuluan në këtë hapësirë dhe janë tregues se teknologjia është përdorur atje.

Për më tepër, mongolët mund ta kenë kaluar teknologjinë jo vetëm përmes ujgurëve dhe territorit persian, por edhe në Evropë, duke përfshirë Gjermaninë. Perandoria mongole e pushtoi Evropën rreth viteve 1000 deri në 1500 pas Krishtit. Ajo periudhë shënoi hyrjen e mjaft ushtarëve dhe robërve të Azisë Perëndimore duke u bërë shkak për futjen e shumë fjalëve nga gjuhët turke në ato evropiane. "Në përgjithësi, nëse diçka kalon nga Azia Lindore [në perëndim], është e vështirë ta imagjinosh pa mongolët", shprehet në një intervistë Christopher Atwood, profesor në në universitetin Indiana (Indiana University) për Euro Azinë Qendrore.

Ideja fantastike që vetëm Gutenbergu e shpiku shtypshkronjën shpërfill një kontinent të tërë dhe përpjekjet e bëra për disa shekuj. Përfundimisht, kapitalistët e hershëm në Evropë investuan në sipërmarrjen e biznesit të Gutenbergut, i cili kombinoi teknologjinë e njëllojtë me të shkronjave të lëvizshme të zbuluara nga Choe Yun-ui, me një mekanizëm spiral që shtrëngohet me vida njësoj si ai që përdoret për të prodhuar vajin e ullirit dhe verën, duke i dhënë shtypshkrimit shpejtësinë që kërkonte tregu. Gutenbergut iu

deshën dekada derisa kjo nismë të jetësohej, më pas u detyrua të falimentonte dhe kjo çoi në procese gjyqësore me investitorët të cilët e paditën për t'u kthyer paratë. Siç vëren Davis në "Gutenbergu i humbur", nga këto dëshmi e njohim Gutenbergun dhe Biblën e tij: "Originën e librit më të famshëm e njohim pak. Historitë që tregojmë për njeriun dhe si u shtyp Bibla, janë krijuar mbështetur në disa dokumente ligjore dhe financiare, dhe për shekuj me radhë studimet kanë plotësuar vetë zbrazëtinë çfarë mungon".

Në të vërtetë, e gjithë historia e shtypshkronjës është plot me zbrazëti. Gutenbergu nuk e tregoi historinë e tij për librat e shtypura në shtypshkronjën që krijoi, arritjen më të mirë të njohurive modern. Ai nuk la asnjë shënim për punën e tij. Dhe nëse Gutenbergu la pas heshtjen, mongolët, bashkatdhetarët e tyre ujgur dhe krerët e qeverisë së Azisë Lindore e bënë këtë edhe më shumë.

Por nëse dyshimet janë të natyrshme, atëherë rezultati që kemi prej tyre nuk është. Ideja fantastike që vetëm Gutenbergu e shpiku shtypshkronjën shpërfill një kontinent të tërë dhe disa shekuj përpjekjesh të rëndësishme dhe nuk bën asnjë përpjekje për të kuptuar se si ose pse teknologjia mund të ishte përhapur më parë. Në një studim të teknikave të krijimit të shkronjave nga Gutenbergu, programuesi kompjuterik Blaise Ag yera y Arcas theksoi se sa e çuditshme është kjo: "Ideja që një teknologji shfaqet plotësisht e përfunduar që në fillim është mashtrim. Kushdo që merret me teknologjinë e di se teknologjia nuk funksionon kështu".

Davis, ka meritën se thekson të njëjtën gjë, duke e shpjeguar: "Ndoshta imazhi i Gutenbergut si gjeni i vetmuar i cili e shndërroi kulturën njerëzore është tërheqës sepse ndryshimi ishte


kaq i jashtëzakonshëm sa ngjati mitik dhe i duhet një histori të tillë origjine për të përkuar me të".

Por Davis, e cila nuk ishte e gatshme të intervistohet për këtë artikull, bën shumë pak për ta korrigjuar këtë të vërtetë tek "Gutenbergu i humbur". Ajo e përmend Kinën vetëm disa herë dhe Korenë vetëm një herë dhe nuk përmend fare mongolët, ujgurët dhe aspektet jo-të krishtera të historisë së shtypshkrimit. Në të vërtetë, ajo nuk e shpjegon fare se Bibla e Gutenbergut nuk pranohet në të gjithë botën si libri më i rëndësishëm në histori. Ashtu si nuk shpejgon se nuk janë kopjet e Biblës librat më të vjetër të krijuar me shkronjat e lëvizshme që ekzistojnë edhe sot – megjithëse lexuesit mund t'i krijohet kjo përshtypje nga "Gutenbergu i humbur".

Përkundrazi, libri më i hershëm i shtypur me shkronja të lëvizshme është libri me autor korean *Baegun Hwasang Chorok Buljo Jikji Simche Yojeo* ("Antologjia e mësimëve Zen të priftërinjve të mëdhenj budist"). Ajo daton në vitin 1377 dhe ka shërbyer si pikënisje e studimeve për origjinën e shtypshkrimit me shkronja të lëvizshme.

Koreja e sheh këtë libër dhe vëllimet e tjera antike si pjesë e krenarisë kombëtare sepse ato renditen ndër librat më të rëndësishëm. Por vetëm kohët e fundit, kryesisht në dekadën e fundit, pikëpamja e tyre dhe fakti që aziatikët krijuan teknologji shtypi shumë më herët kanë filluar të pranohen. Shumica e autorëve që e pranojnë përfshin edhe Davis-in, e cila nuk pranoi të intervistohet me arsyetimin, "Kam frikë se s'kam çfarë të them tjetër për temën e shtypshkrimit në kohëra të lashta" – ashtu si autorët e tjerë, ende nuk e di historinë e plotë.

/Exlibris  
Përktheu Granit Zela




**Makina e Gutenbergut**

E rrallë

## Zhytësi has peshkun raja ngjyrë rozë

Një zhytës që po notonte pranë ishujve Elliot në Australi shpresonte të merrte disa foto të mira të krijesave detare pranë brezit të gjerë koralor, por Kristian Laine nuk e dinte se do t'i bënte disa nga fotot më me fat të botës së egër. Ai hasi në një grup prej gjashtë peshqish raja që po ndiqnin një femër, kështu që mbajti



frymën dhe u zhyt. Teksa merrte fotot ai pa se një nga rajat e grupit nuk ishte e zezë e as e bardhë, por ngjyrë rozë.

## BARSOLETA E DITËS



Flasin dy gjyshe:

- Sa peshon?, e pyet njëra.
- Me syze, 80 kilogramë.
- E pa syze?
- Meqë pa syze nuk e shoh peshoren, nuk di të të tregoj.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

### Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

**Rolet:** Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

**Regjia:** Troy Quane, Nick Bruno



## FOTO E DITES



Një person shihet duke ecur në Francën perëndimore derisa shkuma e detit ia bllokoi rrugën. /AFP/


### Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min  
**Rolet:** Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.  
**Regjia:** Jake Kasdan



### Çdo natë në ora 20:00 STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min  
**Rolet:** Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj.  
**Regjia:** J.J. Abrams



### Çdo natë në ora 22:30 THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

**Rolet:** Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

**Regjia:** Takashi Shimizu



## E jashtëzakonshme

### Studiuesit pretendojnë se kanë zbuluar dhomën sekrete të varrit të Nefertitit

Arkeologët që po punojnë në Luginën e Mbretërve në Egjipt kanë bërë pretendimin sensacional se mund ta kenë zbuluar varrin e shumëkërkuar të mbretëreshës Nefertiti, i cili




besohet se ka qenë i fshehur në një hapësirë të fshehtë në tumën e Tutankhamun. Nëse rezultoni e vërtetë, kjo mund të jetë një nga zbulimet më të mëdha arkeologjike të historisë.



**DASHI**  
Nëse keni dashur të kuptoni diçka për një person të veçantë kohët e fundit, sot është dita e duhur.



**DEMI**  
Për ta shmangur nervozizmin me të dashurin tuaj, përpuniqni të jeni mirëkuptues, ta vendosni veten në vendin e tij në mënyrë objektive.



**BINJAKËT**  
Nuk do t'ju mungojë aspak sharmi, mund të joshni ata që dëshironi me një shikim dhe me disa fjalë intriguese.



**GAFORRJA**  
Për të pasur kënaqësi gjatë rrugës në një nivel praktik, duhet të jeni më konkret se zakonisht.



**LUANI**  
Nëse keni një projekt afër zemrës suaj, duhet t'i kushtoni kohën e duhur dhe të mos e lini pasdore.



**VI RGJËR ESHA**  
Nëse ndiheni pak i lodhur, është për shkak të angazhimeve të shumta që keni pasur këto ditë.



**PESHORJA**  
Mundësia e duhur do të shfaqet kur ju nuk e prisni. Përpuniqni të mos e humbisni atë duke qenë shumë kërkues.



**AKREPI**  
Jini të kujdesshëm sidomos në marrëdhëniet me partnerin ose me anëtarët e familjes suaj.



**SHIGJETARI**  
Surprizat dhe ndryshimet në këtë periudhë nuk mungojnë; vijnë takime të rëndësishme.



**BRICJAPI**  
Përpuniqni t'i zgjidhni problemet që mund t'ju dalë papritur sa më shpejt dhe përqendrohuni në maksimum.



**UJORI**  
Kini shumë gjëra të pashfrytëzuara. Mund t'ju ndodhë një e papritur me veturën. Mos e humb durimin, përqendrohu tek përparësitë.



**PESHQIT**  
Do të përbaleni me punë familjare të lodhshme me të cilat duhet të merreni menjëherë, për t'i shmangur problemet dhe komplikimet më vonë.

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).

## Harry dhe Meghan duan të blejnë një shtëpi shtatë milionë dollarëshe në Kaliforni



**P**ak më shumë informacione kanë dalë në lidhje me planin e zhvendosjes së Princit Harry dhe Meghan Markle në Amerikën e Veriut. Dyshja kanë kaluar shumë kohë në ishullin Vancouver (përfshirë këtu një rezidencë prej 14 milionë dollarësh atje) dhe ka raporte që ata do ta mbajnë Frogmore


Cottage kur ta vizitojnë Mbretërinë e Bashkuar. Por, siç po raportohet, ata po mendojnë për një vend në Malibu, California. California është vendi ku jeton nëna e Meghan, Doria Ragland. "Daily Mail" ka fotografitë e rezidencës prej 7 milionë dollarësh që çifti raportohet se po e shikojnë për ta blerë.

## Gigi Hadidit i kishin thënë se nuk e ka trupin për modele



**G**igi Hadid është një nga modelet më të njohura në botë, por as ajo nuk është 'imune' ndaj kritikave për pamjen e saj. 24-vjeçarja ka rikujtuar për revistën "i-D" fillimet e saj në industrinë e modës gjysmë dekadë më parë kur disajneri i famshëm francez Jean Paul Gaultier ishte i pari që i bëri prova nëse ajo mund të bëhet modele. "Unë isha në përfundim të shkollës së mesme dhe i kisha

format trupore të një voleybollisteje. Ato forma trupore më pëlqenin shumë. E dija se sa shumë kisha punuar që t'i kisha ata muskuj dhe të isha më e bëshme në pjesët e trupit ku unë doja në fakt, ato forma trupore më mungojnë tani. Në atë kohë njerëzit ishin të ashpër ndaj meje duke provuar të më thonë se nuk i kisha format trupore për t'u bërë modele", ka thënë Gigi Hadid.



## Dua Lipa me "Don't Start Now" e para në "Us Pop Radio Chart"

Këngëtarja shqiptare me famë ndërkombëtare, Dua Lipa, po vazhdon ta shijojë suksesin e këngës "Don't Start Now" të cilën e publikoi në nëntor të vitit të kaluar. Nëpërmjet një fotografie në "Instagram", Dua ka njoftuar se kënga e saj është renditur e para në "Us Pop Radio Chart". "Don't Start Now" e para në Us Pop Radio Chart. Çfarë dite. Gëzuar vikendin të gjithëve. Faleminderit, faleminderit

it", ka shkruar krahas postimit të saj Lipa. Kënga e lansuar më 1 nëntor të vitit 2019 në "Youtube" deri më tani ka arritur të mbledhë mbi 146 milionë klikime. "Physical", po ashtu, është një nga këngët e albumit të saj më të ri "Future Nostalgia", i cili do të publikohet më 3 prill. Lipa ka publikuar tri këngë nga ky album: "Don't Start Now", "Future Nostalgia" dhe "Physical".

## Delevingne, Bieberit: Pse nuk po e heq bllokun që ma vure në 'Instagram'?



**K**ëngëtari i njohur Justin Bieber ka treguar se cilat nga shoqet e ngushta të gruas së vet, Hailey, i ka më shumë qejf. Ai këtë e bëri me dije në një lojë në emisionin "The Late Late Show with James Corden". Bieber ato i radhiti nga e preferuara deri tek më pak e preferuara, Kendall

Jenner ishte e para në listë si më e pëlqyera, më pas vinte Gigi Hadid dhe e treta si më pak e preferuara listohet Cara Delevingne. "Nëse nuk ke asgjë kundër meje, atëherë pse nuk më zhblokton? Të dua Hailey Bieber", ka shkruar Delevingne në "Instagram".

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

# Ballkani i pagabueshëm, Gjilani ruan shpresat për titull

Ballkani i Ismet Munishit vazhdon të jetë skuadër pa gabime në elitë. Të dielën Ballkani e fitoi përballjen kundër Ferizajt. Në garë për titull mbetet edhe Gjilani me fitoren ndaj Flamurtarit, kurse Trepça '89 ia ka dhënë edhe një goditje Dukagjinit të Klinës, i cili në edicionin tjetër, me gjasë, do të bëjë gara në Ligën e Parë



**EPOKA E RE** **Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 23 SHKURT** - Kampioni vjesh-tor dhe lideri i Superligës, Ballkani, e ka mposhtur të dielën pa ndonjë problem skuadrën e Ferizajt (3-0). Deri në minutën e 86 rezultati ishte 1-0, por më pas u akorduan dy penallti për vendësit që shënuan edhe dy herë nëpërmjet Arbër Hoxhës dhe Armend Ruxhit. Ky i fundit është portier, por trajneri Ismet Munishi vendosi që ai të jetë ekzekutues i penallisë. Pas kësaj fitore skuadra nga Suhareka e ruan diferencën prej tri pikësh me Dritën dhe Prishtinën, kurse Ferizaj është e dhjeta në tabelë me 19 pikë.

Fitore të rëndësishme në garë për titull të dielën ka shënuar edhe Gjilani në përballje me Flamurtarin e Prishtinës (2-0). Sulmuesi i transferuar në afatin kalimtar të janarit nga Llapi, Sebino Plaku, e kaloi Gjilanan në epërsi në fund të pjesës së parë, kurse golin e dytë dhe të fundit për skuadrën e Gjilani e shënoi Tomislav Busiq në pjesën e dytë. Pas këtyre tri pikëve Gjilani vazhdon të jetë në garë për titull me pesë pikë pas skuadrës lidere, kurse kuqezinjtë nga kryeqyteti kanë 22 pikë dhe renditjen në pozitën e nëntë.

Të dielën fitores i është gëzuar edhe skuadra e Trepçës '89, e cila me përmbyse fitoi kundër Dukagjinit të Klinës. Mysafirët shënuan të parët me anë të Mark Milicajt, kurse rezultatin mitrovicasit e përmbysen me dy golat e shënuar nga Arb Manaj. 89-shi renditet

në vendin e shtatë me 26 pikë, katër më shumë se Flamurtari në pozitën e nëntë, që dërgon një rang më poshtë në futbollin e Kosovës. Ndërsa skuadra e Dukagjinit vazhdon të jetë në pozitën e fundit me vetëm nëntë pikë të grumbulluara. Dy ndeshjet e tjera të kësaj xhiroje janë zhvilluar të shtunën. Fituese kanë dalë Prishtina dhe Llapi në përballje me Drenicën, përkatësisht Feronikelin. Kryeqytetasit triumfuan në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Bajram Aliu" në Skenderaj (1-3). Golat për bardhekaltrit e kryeqytetit i shënuan Oto John (13'), Ergyn Ahmeti (30') dhe Ahmed Januzi (54'), derisa golin e vetëm për kuqezinjtë e realizoi Coulibaly (80').

Fitore tejet të rëndësishme për ta ruajtur hapin me skuadrat e kreut ka shënuar edhe Llapi para tifozëve të vet në "Zahir Pajaziti", duke e mundur kampionin në fuqi, Feronikelin, me rezultat 2-1. Ersil Ymeraj shënoi dy gola për fitoren e llapjanëve, kurse për skuadrën nga Drenasi golin e vetëm e realizoi Ilir Berisha. Pas kësaj fitoreje Llapi mbetet në pozitën e 6-të, por me 28 pikë, aq sa ka edhe Feronikeli në pozitën e pestë.

## Besa e nis sezonin pranveror me fitore

Është zhvilluar java e parë e sezonit pranveror në Ligën e Parë të Kosovës në futboll. Skuadra e Besës së Pejës ka arritur fitore të rëndësishme në përballje me Vitinë (2-0) dhe në këtë

mënyrë prin në renditjen tabelore. Skuadra e Arbërisë e mposhti me rezultat minimal 1-0 Ramiz Sadikun, për të qenë skuadra e dytë në renditjen tabelore. Ndërsa Liria e Prizrenit është mposhtur të shtunën nga KEK-u në Obiliq (1-0).

### IPKO Superliga

Ballkani - Ferizaj	3-0
Gjilani - Flamurtari	2-0
Trepça '89 - Dukagjini	2-1
Llapi - Feronikeli	2-1
Drenica - Prishtina	1-3
Vushtrria - Drita	2-3

### Tabela

1. Ballkani	19	40 pikë
2. Drita	19	37
3. Prishtina	19	37
4. Gjilani	19	35
5. Feronikeli	19	28
6. Llapi	19	28
7. Trepça '89	19	26
8. Drenica	19	24
9. Flamurtari	19	22
10. Ferizaj	19	19
11. Vushtrria	19	15
12. Dukagjini	19	9

Në xhiron e radhës takohen: Dukagjini-Gjilani, Drita-Drenica, Prishtina-Ballkani, Flamurtari-Vushtrria, Feronikeli-Trepça '89, Ferizaj-Llapi.

### LIGA E PARË

Drenasi - Vëllaznimi	1-1
KEK-u - Liria	1-0
Ramiz Sadiku - Arbëria	0-1
Malisheva - Vllaznia	1-0
Besa - Vitia	2-0
Ulpiana - Trepça	3-1
2 Korriku - Dardana	1-0
Onix - Istogu	2-1

### Tabela

1. Besa	17	31 pikë
2. Arbëria	17	30
3. Malisheva	17	29
4. Onix	17	26
5. Liria	17	26
6. 2 Korriku	17	26
7. Istogu	17	26
8. Drenasi	17	24
9. KEK-u	17	24
10. Dardana	17	23
11. Ulpiana	17	21
12. Trepça	17	19
13. Vëllaznimi	17	17
14. Vllaznia (P)	17	16
15. Ramiz Sadiku	17	15
16. Vitia	17	15

## SHKURT

### Feronikeli ndan rrugët me Bunjakun dhe Sopin

Skuadra e Feronikelit, pas humbjes në ndeshjen ndaj Llapit në Superligë, ka ndarë rrugët me këshilltarin e presidentit Naser Ramaj, Albert Bunjaku dhe trajnerin Agim Sopi. "Pas ndeshjes drejtues të KF Feronikelit kanë mbajtur takim me këshilltarin e presidentit, Albert Bunjaku dhe trajnerin e Klubit të Feronikelit, Agim Sopi. Me një marrëveshje të dyanshme dhe pas një takimi krejtësisht miqësor u vendos që të ndahen rrugët mes dyshes Bunjaku dhe Sopi, me Klubin e Feronikelit", thuhet në njoftimin e skuadrës kampione të Kosovës. Skuadra nga Drenasi i ka uruar shumë suksese Bunjakut dhe Sopit në hapat e tyre të mëtuqjeshëm dhe i ka falënderuar për korrektësinë dhe profesionalizmin e treguar gjatë kohës sa ishin në klub.

### Besa e fiton derbin dramatik ndaj Prishtinës

Besa Famgas e ka fituar derbin ndaj Prishtinës me rezultat 26:24. Kjo ndeshje është zhvilluar të shtunën në palestrën "Karagaçi" në Pejë. Besa është forcuar në vend të parë me 32 pikë. Tani ka katër më shumë se Prishtina që është e dyta. Të dyja humbjet e këtij edicioni Prishtina i ka pësuar nga Besa. Ekipi pejan ka vetëm fitore. Prce ka udhëhequr Besën me 9 gola. Nga pesë i shënuan Gjuka e Tahirukaj. Te Prishtina më efikasit ishin Terziqi e Ramadani me nga 5 gola.

### Mabetex Prishtina triumfon ndaj Bashkimit

Mabetex Prishtina ka fituar derbin e javës së 12-të në Superligën e femrave, duke mundur Bashkimin me rezultat 82:76 (23:9, 23:13, 21:28, 15:26). Prishtina e nisi ndeshjen për mrekulli, duke fituar çerekun e parë bindshëm 23:9. Me lojë të mirë vazhdoi edhe në periodën e dytë, me një seri prej 7:0, derisa këtë pjesë e fitoi 23:13, duke shkuar në pushim me epërsi prej 46:22. Por, Bashkimi u rikthye në pjesën e dytë. Vashat prizrenase fituan në periodën e tretë 21:28 dhe atë të fundit 15:26, duke afruar rezultatin në 82:76, rezultat me të cilin përfundoi ndeshja. Më e mira te Prishtina ishte Irma Konjusha me 35 pikë e tetë kërcime, kurse te Bashkimi u dalluan Jeta Zeka me 28 pikë e pesë kërcime dhe Saranda Daci me 23 pikë e 13 kërcime. Në takimet e tjera të kësaj xhiroje, Penza ka mundur Trepçën me rezultat 66:46. Vëllaznimi ka shënuar fitoren e parë në këtë edicion, duke mundur Kastriotin në udhëtim 40:91.

## Ambasada Amerikane, futbollistit serb: Kosova është shtëpia juaj

PRISHTINË, 23 SHKURT - Ambasada Amerikane në Kosovë përmes rrjeteve sociale ka mbështetur futbollistin serb, Ilija Iviq, i cili ka vendosur që të luajë për Kosovën. Mirëpo një vendim i

tillë nuk ka kaluar pa pasoja, pasi të dy prindërit e tij janë larguar nga puna për shkak të vendimit të tij për të luajtur me Kosovën U19. Ambasada Amerikane thotë se Iviq me veprimin e tij ka inspiruar

shumë të rinj në Kosovë, derisa thekson se politika nuk ka vend në sport. "Urime për Ilija Iviqin! Ai po inspiron të gjithë të rinjtë në Kosovë që të punojnë shumë, ta zhvillojnë talentin dhe t'i ndjekin ëndr-

rat e tyre. Politika nuk ka vend në sport. Ky është një moment për ta festuar diversitetin dhe një sportist të talentuar në Kosovë. Kosova është shtëpia juaj", ka shkruar Ambasada amerikane.



## Fury, pas fitores ndaj Wilderit: Mbreti u kthye në fron

LONDËR, 23 SHKURT - Britaniku Tyson Fury ka pasur performancë dominuese në meçin për titull bote ndaj Deontay Wilderit të dielën në mëngjes, duke fituar titullin përmes ndërprerjes së meçit në raundin e shtatë në Las Vegas. Meçi i dytë mes dy supergaruesve u dominua nga Fury vazhdimisht që e rrëzoi dy herë për tokë Wilderit. Gjyqtari ndërpreu meçin në raundin e shtatë kur ekipi i Wilderit u dorëzua. Britaniku 31-vjeçar, që tani ka serinë 30 fitore e vetëm një barazim, është kampion i ri i botës në kategorinë e rëndë në WBC. Për Wilderit kjo ishte humbja e parë në karrierën profesionale pas 42 fitoreve e një barazimi. Meçi mes dy boksiereve në dhjetor të 2018-s kishte përfunduar baras. "Më duhet të them se mbreti u kthye në fron", ka thënë Fury pas meçit. "Wilderit tregoi zemër kampioni. Ai është luftarak, do të rikthehet, dhe do




të jetë sërish kampion", ka shtuar Fury teksa ka deklaruar se pret që amerikanët të kërkojnë meçin e tretë. Në anën tjetër, në deklaratën pas meçit, Wilderit që pësoi humbjen e parë deklaroi se "edhe më të mirët në histori kanë humbur e janë kthyer".

"Gjërat si këto ndodhin, më i miri fitoi sonte. Ekipi im hodhi peshqirin - unë do të preferoja të mbrohesh vetë. Edhe më të mirët kanë humbur dhe janë rikthyer, duhet ta pranoni këtë. Kjo është për çka ekziston boksi. Më i miri duhet të luftojë më të mirin", ka thënë Wilderit.

## Clippersat mposhten nga Sacramento, Milwaukee pa problem fiton ndaj Philadelphias

LOS ANXHELOS, 23 SHKURT - Los Angeles Clippers ka pësuar humbje befasuese para adhuruesve të vet nga Sacramento Kings. Skuadra nga Kalifornia ka pësuar humbje me nëntë pikë diferencë 103-112. Kent Bazemore ishte më efikas për ekipin fitues me 23 pikë e gjashtë kërcime, ndërsa Fox shtoi 20 të tjera. Kawhi Leonard te vendësit ishte fantastik me 30 pikë, tetë kërcime e pesë asistime, por që nuk i mjaftuan për fitore. Fitore ka shënuar edhe Milwaukee Bucks, ku para adhuruesve të vet ka mposhtur Philadelphia 76ers me rezultat 119-98. Giannis Antetokounmpo ishte fantastik në këtë përballje me 31 pikë, 17 kërcime e tetë asistime. Me këtë



### REZULTATET

LA Clippers - Sacramento Kings  
Charlotte Hornets - Brooklyn Nets  
Atlanta Hawks - Dallas Mavericks  
Chicago Bulls - Phoenix Suns  
Miami Heat - Cleveland Cavaliers  
Milwaukee Bucks - Philadelphia 76ers  
Utah Jazz - Houston Rockets

103-112  
86-115  
111-107  
104-112  
124-105  
119-98  
110-120

fitore Bucks vazhdon bindshëm në pozitën e parë në Konferencën e Lindjes me 48 fitore e tetë humbje, ndërsa 76ers mbetet në pozitën e pestë me 35 fitore e 22 disfata.

### SHKURT

#### Khaka: Arteta më bëri sërish të lumtur në Arsenal

Mesfushori i Arsenalit, Granit Xhaka, e ka pranuar se trajneri Mikel Arteta e kishte bindur të qëndrojë në klub dhe thotë se, falë tij, tani ndihet i lumtur dhe e bën atë që i pëlqen më së shumti; të luajë futboll për ekipin e "Topçinjve". Pasi ishte lënë jashtë nga Unai Emery, Xhaka së pari u rifut në ekip nga trajneri i përkohshëm Freddie Ljungberg, para se Arteta të vinte në postin e trajnerit dhe ta theksonte rëndësisë e shqiptarit për Arsenalin. "Tani më duhet të buzëqesh paksa, sepse jam shumë, shumë i lumtur që jam kthyer dhe po e shijoj atë që e dua më së shumti: të luaj për këtë klub dhe të luaj futboll", ka thënë Xhaka. "E pata një takim shumë, shumë të mirë me atë (Artetan), tri ditë pasi ai erdhi në klub. Ai m'i tha shumë gjëra dhe unë isha shumë i hapur me të, siç ishte edhe ai shumë i hapur me mua", shtoi 27-vjeçari. "Dhe tani të jemi këtu, të dy shumë të lumtur për ta çuar këtë klub aty ku e ka vendin", theksoi shqiptari.

#### Maldini: Ibra qëndron nëse kualifikohemi në Ligën e Kampionëve

Zlatan Ibrahimović me kalimin e tij te Milani në afatin kalimtar të dimrit i ka ndryshuar fytyrën skuadrës kuqezi, pavarësisht se ekipi i Piolit është ende larg zonës Champions. Që Ibra të qëndrojë te Milani edhe sezonin e ardhshëm pasi ka firmosur për 6 muaj me opsion rinovimi edhe për një tjetër vit, rinovim që mund të vijë automatikisht nëse plotësohet një kusht dhe kushtin e ka zbuluar në intervistë për media italiane drejtuesi Paolo Maldini. "Me Ibrën kemi firmosur kontratë gjashtëmuajore me rinovim automatik nëse kualifikohemi në Ligën e Kampionëve. Nëse nuk e arrijmë këtë, është e natyrshëm të bisedojmë për qëndrimin e tij. Me Ibrën gjithnjë ekziston një diskutim personal në të cilin gjithmonë duhet të ketë një dialog të hapur. Gjithmonë ka qenë kështu, përndryshe ai nuk do kishte ardhur këtu", ka thënë Maldini.

#### Cascarino: Mourinho ka mbetur mbrapa nga futbollit modern

Ish-futbollisti, tashmë analist, Tony Cascarino, pretendon se futbollit modern e ka lënë mbrapa Jose Mourinho. "Mendoj se Jose Mourinho ka mbetur mbrapa", shprehet Cascarino për "talkSPORT". "Nëse sheh karrierën e tij në vitet e fundit, ajo gradualisht ka shkuar në rënie. Ai gjithmonë fiton trofe, nuk mund ta mohosh, por tani jam duke parë një trajner i cili po largohet gradualisht nga kjo lojë. Mourinho që erdhi në vitin 2000 në Angli te Chelsea nuk është ky i sotmi. Mourinho duhet ta vërtetojë se nuk ka mbaruar, sepse futbollit mbrojtës ka ikur. Ndeshja e Atletico ndaj Liverpoolit ishte një përjashtim. Futbollit sulmues po dominon", ka thënë Cascarino.

#### Lajm i keq për Realin, Hazardi mungon gjatë

Eden Hazard doli nga loja duke çaluar në humbjen 1-0 të Real Madridit nga Levante të shtunën në mbrëmje. Ylli belg jo vetëm që do t'i humbasë ndeshjet e ardhshme kundër Manchester Cityt dhe Barcelonës, por pothuajse do humb gjithë sezonin. Edhe pse Real Madridi nuk e specifikoi se sa kohë do të mungojë Hazard, ajo që është e qartë është se ai ka pësuar një dëmtim të rëndë. Klubi nga "Santiago Bernabeu" ka njoftuar të dielën se janë kryer testet mjekësore të yllit belg. "Ai ka pësuar një frakturë në fibulën e djathtë distale", lexohet në raportin mjekësor të Realit. "Shërimi i tij do të vazhdojë të vlerësohet", mbyllet njoftimi i klubit spanjoll. Gjatë konferencës së tij për shtypin pas ndeshjes, Zinedine Zidane pranoi se dëmtimi i Hazardit "duket i keq". Vlen të përmendet se ky lëndim është në të njëjtën këmbë që bëri që sulmuesi të mbetet jashtë fushave për gati tre muaj.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 12.02.2020 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeqare, K.R.M. "Uniteti" Sh.A vendosi që më datë 24.02.2020 të shpallë:

**KONKURS PUBLIK**  
**Për plotësimin e vendeve të punës:**

**3 (tre) Vozitësa të kategorisë "C"** - Njësia në Skenderaj me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeqare), me mundësi vazhdimi

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Sipas Urdhërësës së Punës drejton automjetin dhe kujdeset për rregullësin, higjienën dhe pastërtin e tij.
- Është përgjegjës për vozitje të sigurt dhe për kryerjen me kohë, efikasë dhe kualitative të shërbimeve në bartjen e mbeturinave, larjen e rrugëve etj.
- Në rastet kur e kryen terrenin e caktuar angazhohet në pika (zona), tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit-kryepunëtorit,
- Para daljes në teren merr Urdhërësën e Punës në të cilën evidencen punët e kryera, vërejtjet mbi pengesat dhe defektet në automjet, dhe të njëjtën e kthen te dispečeri,
- Vendos (monton) letren e re të tahograftit ndërsa letren paraprake e kthen te dispečeri, brenda 12 orëve,
- Vozitësi i cili e monton letren e tahograftit ka obligim që në të shënon: Emrin e tij, numrin e regjistrimit të automjetit, datën dhe kilometrazhën fillestare dhe përfundimtare,
- Është i obliguar që në automjet të ketë njetet e nevojshme të punës (lopata, fshisat etj.), për ekipën e punëtorëve me të cilët punon, largon (bartë) shtazët e ngordhura dhe i evidenton në urdhërësen e punës.
- Në rast nevojë ndrron gomat e automjetit në teren, apo në punëtorinë e mirëmbajtjes në bashkëpunim me gomisterin.
- Është i obliguar që prishjet në automjet me kohë të i lajmron me shkrim te udhëheqësi i drejtëpërdrejt dhe në punëtorinë e mirëmbajtjes
- Çdo sjellje të pandërgjegjësme të punëtorëve me të cilët punon vozitësi është i obliguar që ta paraqet te udhëheqësi i drejtëpërdrejtë
- Kryepunëtori e njofton kryepunëtorin për kontejnerët e dëmtuar dhe sipas kërkesës së tij, bënë bartjen e tyre në punëtorinë e mirëmbajtjes për riparim,
- Është i obliguar që në Deponi të mbeturinave tu përmbahet rregullave dhe obligimeve të parapara në lidhje me procesin e punës në Deponi,
- Nëse automjeti me të cilin punon ndodhet në prishje apo jashtë planit momental për përdorim, është i obliguar që të drejton automjetin tjetër, dhe të kryen punë tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit, të drejtëpërdrejtë nevojës së procesit të punës dhe interesit të ndërmarrjes.

**Kualifikimet**

- Të ketë diplomën e shkollës fillore ose të mesme
- Vozitësi i kategorisë "C"
- Të prezantoj leternjoftimin
- Çertifikatë nga gjykata se nuk jeni i/e denuar (më e re se 6 muaj)

**Kushtet e veçanta:**

Punëtori 6 (gjashtë) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do ti vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mundë të dorëzohen në Zyrën e Arkivës në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë. Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 24.02.2020 deri më datën 09.03.2020. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 12.02.2020 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendeve të punës për periudhën e ardhshme një vjeqare, KRM "Uniteti" Sh.A vendosi që më datë 24.02.2020 të shpallë:

**KONKURS PUBLIK**

Për plotësimin e vendit të punës:

**Receptionist/e** -Njësia në Skenderaj me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeqare), me mundësi vazhdimi

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Përgjigjet në thirrjet telefonike, përcakton qëllimin e tyre dhe i transferon, përcjell ato tek zyrtarët përkatës;
- Përgjigjet pyetjeve lidhur me Kompaninë dhe orienton palët për realizimin e kërkesave të tyre si dhe jep informacione tjera;
- Pranon informatat përmes telefonit dhe faksit dhe i përcjell ato tek zyrtarët përkatës;
- Mirëpret vizitorët, përcakton qëllimin e vizitës së vizitorëve dhe i njofton zyrtarët përkatës të njësive lidhur me vizitorin;
- Monitoron hyrjen dhe daljen e vizitorëve dhe i pajis me leje kalime nëse kërkohet për qasje në ndërmarje si dhe mbanë regjistrin për hyrjet dhe daljet;
- Pranon dhe regjistron postën zyrtare dhe adreson tek personat përkatës të Kompanisë;
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

**Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:**

- Të ketë shkollën e mesme;
- Të prezantoj leternjoftimin;
- Çertifikatë nga gjykata se nuk jeni i denuar (më e re se 6 muaj);
- Shkathtësi në komunikim, me stafin brenda Kompanisë;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel); ose administrative.

**Kushtet e veçanta:**

Punëtori 6 (gjashtë) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do ti vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mundë të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë. Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 24.02.2020 deri më datën 09.03.2020. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 12.02.2020 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendeve të punës për periudhën e ardhshme një vjeqare, KRM "Uniteti" SH.A vendosi që më datë 24.02.2020 të shpallë:

**KONKURS PUBLIK**

Për plotësimin e vendeve të punës:

**7 (shtatë) Punëtor Fizik** -Njësia në Skenderaj me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeqare), me mundësi vazhdimi

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave në automjete - kamion kompaktor dhe traktor,
- Zbrazen e kontejnerëve dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre nga zona e shërbimit gjerë në deponi.
- Kryen pastrimin, larjen dhe spërkatjen e sipërfaqeve publike, rrugëve dhe shesheve.
- Kryen punët e grumbullimit të mbeturinave në kontejner, kryen punët rreth pastrimit të borës, hedhjes së kripës industriale, heqjen e akullit,
- Është i obliguar të ketë sjellje korrekte ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve.
- Është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të kontejnerëve gjatë punës, kryen edhe punë tjera të natyrës së ngajshme të cilat i cakton udhëheqësi i tij i drejtëpërdrejtë.

**Kualifikimet e kërkuara:**

- Të ketë shkollën fillore ose së paku një vit përvojë pune
- Të prezantoj leternjoftimin
- Çertifikatë nga gjykata se nuk jeni i denuar (më e re se 6 muaj)

**Kushtet e veçanta:**

Punëtori 6 (gjashtë) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do ti vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mundë të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë. Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 24.02.2020 deri më datën 09.03.2020. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.

RESTAURANT

SWISS  
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës  
Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-  
Hospital and University Clinical Service of Kosovo  
Sektori i Personelit në SHSKUK

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
SHËRBIMI SPITALOR DHE KLINIK UNIVERSITAR I KOSOVËS UNIVERZITETSKA BOLNIČKA I KLINIČKA SLUŽBA KOSOVA- THE HOSPITAL AND UNIVERSITY CLINICAL SERVICE OF KOSOVO	
ARKIVI QENDOR - CENTRALNI ARHIV - CENTRAL ARCHIVE	
Nr i njësës org org.jed org.unit	Nr Prot. Grup. prot. Prot. no
Nr i faq Gr. str. No. page	Data Datum Date
-/-	18/4 21.02.20
PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA	

Në mbështetje të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, të nenit 13 të Statutit të SHSKUK-së, në mbështetje të nenit 6 paragrafi 5 pika 5.1 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së me datë 21.02.2020 merr këtë:

### VENDIM

- I. **ANULOHE**t Konkursi Publik me nr. prot. 18 i datës 10.01.2020 për pozitën Drejtor Ekzekutiv në Spitalin e Përgjithshëm "Sami Haxhibeqiri" në Mitrovicë
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

### ARSYETIM

Pas përfundimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve për pozitën drejtor ekzekutiv në SP Mitrovicë, si dhe pas shqyrtimit të aplikacioneve nga komisioni përzgjedhës, komisioni njofton se për këtë pozitë i kanë plotësuar kriteret vetëm dy (2) kandidatë. Në bazë të nenit 6 paragrafi 5 pika 5.1 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, konkursi anulohet në rast se tre (3) kandidatë nuk i plotësojnë kriteret e konkursit. Në respektim të ligjit dhe akteve nën ligjore konkursi anulohet si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese pranë Komisionit të Ankesave në kuadër të SHSKUK-së, nëpërmjet Sektorit të Personelit, në afat prej 15 ditë nga publikimi i këtij vendimi.

Dr. Basri Sejdiu  
Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së

Vendimi i dërgohet:

- Sektorit të Personelit - SHSKUK
- Drejtorit të Përgjithshëm
- Kandidatëve për këtë pozitë
- Në gazetën ditore
- Arkivit

### NJOFTIM

Njoftojme te gjithë klientet se Kompania " Viva Trade " sh.p.k me seli ne Prizren , ka marre vendim te shuaje biznesin me numer te rregjistrimit 810049959 , dhe ka caktuar likuidatorin per zhvillimin e procedures se Likuidimit . Njoftohen te gjithë klientet qe kane raporte Kreditore - Debitore ne kete shoqeri qe te paraqiten ne afatin 30 ditor nga data e shpalljes ne gazet

### OBAVESTENJE

Obavjestavamo se svi klienti da Tvrtka " Viva Trade " L.L.C u Prizren , doneo odluku da ugasi biznis po br. registra 810049959 i ujedno imenovao Likfidatora o sporovodjenju postupka likfidacije . Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi , da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine .

### ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Company " Viva Trade " L.L.C in Prizren has come to the decision to quit its business with registry nr 810049959 . The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidatorprocess. All clients who have the mortgager - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement publication .

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

**Kërkoj kujdestare  
për vajzën 7 muajshe  
në Prishtinë.  
Për informata në  
tel: 044-444-009**

► Hysni Hasani, shpall të pavlefshme dëftesat (kl. I - VIII ) SHF. "28 Nëntori " Polac.

► Leutrim Mulaj, shpall të pavlefshme dëftesat e vitit (I - II) SHMT "Anton Çetta" Skenderaj.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veterikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

**Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistrallja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare.  
Tel. 044-413-197.**



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

